

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030

MIRATUAR ME

VENDIMIN NR. 1 DATË 24.07.2024

KOMITETI I BASHKËRENDIMIT TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

QERSHOR 2024

FALENDERIME

Agjencia e Inteligjencës Financiare falënderon të gjithë **anëtarët e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës** për kontributin e tyre në hartimin e “Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 204-2030”.

Agjencia e Inteligjencës Financiare falënderon në mënyrë të veçantë **GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) GmbH** që nëpërmjet mbështetjes financiare me kontraktimin e një eksperti kombëtar ndihmoi në hartimin e draftit të parë të këtij dokumenti. Gjithashtu, Agjencia e Inteligjencës Financiare vlerëson kontributin e dhënë nga **Veprimi kundër Krimin Ekonomik, pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”** për rishikimin e Strategjisë dhe Planit të tij të Veprimit në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Agjencia e Inteligjencës Financiare falënderon posaçërisht **“American Bar Association | Rule of Law Initiative”** dhe **Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)** për ndihmën e ofruar në përkthimin dhe publikimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
I. PROCESI I HARTIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN E PP/FT	10
II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REGJIMIT TË PPP/FT NË SHQIPËRI.....	11
2.1 Kudri ligjor për pastrimin e parave	11
2.2 Kudri ligjor për financimin e terrorizmit.....	12
Konventat Ndërkombëtare të Fushës	13
2.3 Ligje me karakter administrativ për parandalimin e PP/FT	14
2.4 Funksionimi i sistemit të parandalimit dhe luftës ndaj PP/FT	15
III. FAKTORËT KRYESORË KONTRIBUES NË FORMULIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PPP/LFT	19
3.1 Mangësitë e identifikuar nga organet monitoruese/vlerësuese.....	20
3.2 Politikat dhe planet përkatëse të nivelit të lartë.....	23
3.3 Rezultatet e Vlerësimit Kombëtar të Riskut.....	26
3.4 Konteksti ndërkombëtar	35
3.5 Mjedisi aktual dhe trendet e sektorit financiar	39
3.6 Konteksti i Sigurisë Kombëtare	39
3.7 Pastrimi i parave dhe kërcënimet nga financimi i terrorizmit.....	41
IV. FUSHAT KRYESORE STRATEGJIKE.....	43
V. QËLLIMI, OBJEKTIVAT SPECIFIK DHE TREGUESIT E NIVELIT STRATEGJIK.....	44
5.1 Vizioni dhe misioni i Strategjisë	45
5.2 Objektivi nr.1: Përmirësimi i kudrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional.....	45
5.3 Objektivi nr.2: Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues	47
5.4 Objektivi nr.3: Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT	48
5.5 Objektivi nr.4: Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet	49

5.6	Objektivi nr.5: Rritja e efektivitetit të sistemit mbikëqyrës	51
5.7.	Objektivi nr.6: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	52
VI.	MONITORIMI DHE VLERËSIMI	54
ANEKS 1:	TABELA E PLANIT TË VEPRIMIT.....	55

SHKURTIMET

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AMLF	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ASHM	Armët e Shkatërrimit në Masë
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BMP	Bordi i Mbikëqyrjes Publike
BSH	Banka e Shqipërisë
CVE	Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DNFBP	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jo financiare
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
RPKV	Republika Popullore Demokratike e Koresë Veriut
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterëve
FATF	Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
FINTECH	Teknologjia Financiare
GTNP	Grupi Teknik Ndërinstitucional Punës
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale
ICRG	Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar

IFJB	Institucion Financiar Jo-Bankë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikeve të Interesave
Indeksi TI	Indeksi Ndërkombëtar i Transparencës
INSTAT	Instituti i Statistikave
KBLKPP	Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
KSKB	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
LHT	Luftëtarët e Huaj Terroristë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
mld	miljard
mln	milion
Moneyval	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NAREA	Shoqata Shqiptare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NRA	Vlerësimi Kombëtar i Riskut
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PAMECA	Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Evropian në Shqipëri
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
PF	Person Fizik
PJ	Person Juridik
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PP/FT	Pastrimi i Parave/ Financimi i Terrorizmit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit

RAD	Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
RSH	Republika e Shqipërisë
SFJB	Subjekt Financiar Jo-Bankë
SPAK	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
STR	Raporte të Transaksioneve të Dyshimta
Sh.a	Shoqëri anonime
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
SHKK	Shoqëri Kursim-Krediti
Sh.p.k	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
TEDA	Zona të Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjik
TE-SAT	Raporti i Situatës dhe Trendit të Terrorizmit
TFS	Sanksione kundër Financimit të Terrorizmit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
VASP	Ofruesi i Shërbimit të Aseteve Virtuale
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKV	Zyrë e Këmbimit Valutor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit komprometojnë integritetin e sistemit ekonomiko-financiar dhe janë një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare dhe atë globale. Qeveria e Shqipërisë, është e angazhuar në parandalimin dhe goditjen e këtyre veprave penale, duke punuar vazhdimisht për të përmirësuar regjimin e saj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT), në përgjigje të rreziqeve të reja që diktohen në nivel vendi dhe më gjerë. Në këtë kontekst nga Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës në bashkëpunim të ngushtë me ekspert të vënë në dispozicion nga GIZ si dhe rishikuar nga ekspert i caktuar nga Projekti i KiE, është hartuar “Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030”, bazuar në kontributin konkret të dhënë nga agjencitë e zbatimit të ligjit, institucionet rregullatore, palët e interesuara të sektorit privat dhe ekspertë të fushës së parandalimit të PP/FT.

Kuadri ligjor i PP/FT në Shqipëri, përbëhet nga ligje dhe akte nënligjore gjithëpërfshirëse që përcaktojnë në mënyrë të qartë përgjegjësitë e agjencive të ligjit, institucioneve shtetërore dhe private të përfshira në parandalimin dhe goditjen e PP/FT duke respektuar ndarjen e pushteteve sipas Kushtetutës.

Regjimi kundër PP/FT është një përpjekje bashkëpunuese, që kërkon koordinim në të gjitha nivelet e qeverisjes, sektorëve publikë dhe privatë dhe partnerëve ndërkombëtar. Ky regjim përfshin agjenci dhe institucione, me mandate dhe fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë, të koordinuara dhe të udhëhequra nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP).

Brenda sektorit privat, subjektet raportuese luajnë një rol kritik në përpjekjet për të parandaluar dhe zbuluar PP/FT, duke respektuar detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Këto subjekte ndërmarrin hapa konkret për të luftuar pastrimin e parave dhe krimet e lidhura me të duke bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë e Inteligjencës Financiare dhe institucionet të tjera shtetërore, përfshirë dhe në formën e partneriteteve publike-private.

Në nivel ndërkombëtar, qeveria Shqiptare bashkëpunon me një rrjet organizmesh për të trajtuar në mënyrë efektive kërcënimet komplekse dhe në zhvillim të sigurisë që përfshijnë PP/FT. Këtu përfshihen Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF), Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, Grupi Egmont i Njësive të Inteligjencës Financiare dhe një sërë organesh të tjera ndërkombëtare. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi synohet të identifikohen tendencat në zhvillim, të shkëmbehet informacion dhe të zbatohen praktikatat më të mira ndërkombëtare për të parandaluar dhe luftuar PP/FT.

Për të siguruar efektivitetin e tij, regjimi kundër PP/FT duhet të përshtatet vazhdimisht me ndryshimet në mjedisin e tij operacional, të diktuar ndër të tjera dhe nga prirja e rëndësishme

drejt digjitalizimit të sektorit financiar i cili ka ndryshuar mënyrën se si klientët ndërveprojnë me këtë sektor – duke ofruar mundësi për qytetarët, por edhe duke sfiduar qasjet ekzistuese ndaj çështjeve rregullatore dhe atyre të zbatimit të ligjit.

Për t'iu përgjigjur kërcënimeve në zhvillim të PP/FT agjencitë dhe institucionet Shqiptare kryejnë vlerësime dhe publikojnë raporte strategjike të inteligjencës për t'u ofruar politikëbërësve informacionin e nevojshëm për të adresuar boshllëqet e shfaqura dhe për të siguruar informimin dhe ndërgjegjësimin për rreziqet e reja. Këtu përfshihet dhe Vlerësimi Kombëtar i Riskut PP/FT i miratuar nga KBLKPP në muajin Dhjetor të 2023, në të cilin janë evidentuar rreziqet e PP/FT me të cilat përballen sektorë të veçantë të sistemin ekonomiko-financiar të vendit.

Rishikimet e fundit të regjimit PP/FT në Shqipëri, kanë dëshmuar se ai është përgjithësisht efektiv, i bazuar në politika në nivel kombëtar si dhe koordinimin operacional. Çështjet që kërkojnë përmirësim janë evidentuar në vlerësime të ndryshme, duke përfshirë raportin e vlerësimit të ndërsjellë të Shqipërisë nga Komiteti Moneyval i vitit 2018, procesi i mbikëqyrjes së vendit.

Këto përfshijnë dobësi në shkëmbimin e informacionit, nivele të ulëta të hetimeve dhe ndjekjeve penale për PP/FT, si dhe boshllëqe legjislative që janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Për t'iu qasur këtij konteksti në zhvillim dhe për të adresuar boshllëqet e identifikuar, “Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit” përmban prioritetet e qeverisë Shqiptare për të parandaluar dhe luftuar PP/FT gjatë periudhës 2024-2030. Këto prioritete janë grupuar në gjashtë objektiva: (1) Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstucional; (2) Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues; (3) Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT; (4) Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet; (5) Rritja e efektivitetit të sistemit mbikëqyrës; (6) Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Nëpërmjet zbatimit të kësaj strategjie synohet konsolidimi i mëtejshëm i regjimit Shqiptar të PP/FT në përputhje me ndryshimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kërcënimet përkatëse PP/FT.

Kjo është strategjia e dytë e miratuar nga Qeveria Shqiptare dhe ndër të tjera dëshmon rëndësinë e llogaridhënies publike dhe transparencës për të siguruar suksesin e regjimit PP/FT. Konteksti operacional i regjimit është në ndryshim të vazhdueshëm dhe për rrjedhojë strategjia do të jetë subjekt rishikimi dhe përditësimi i mëtejshëm nga institucionet e përfshira në zbatimin e saj. Strategjia përmban dhe një plan të detajuar veprimi për masat konkrete që do të ndërmerren në nivel instucional.

I. PROCESI I HARTIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN E PP/FT

Strategjia kombëtare për parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT (në vijim Strategjia) është produkt i një procesi koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, bazuar mbi praktikën më të mirë të fushës, nevojat e evidentuara nga ana e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë, si dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtare.

Procesi i hartimit ka kaluar në disa faza:

Në dhjetor 2023, KBLKPP vendosi për hartimin e Strategjisë brenda 6-mujorit të parë 2024. Kjo detyrë iu caktua Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës (GTNP) me përfaqësues nga të gjithë institucionet anëtare në KBLKPP. Nëpërmjet asistencës nga GIZ u kontraktua ekspertiza e nevojshme për draftin e parë të dokumentit, i cili erdhi si proces i zhvillimit të disa takimeve me aktorët kryesorë (publik dhe privat) të sistemit.

Në funksion të hartimit të kësaj strategjie, u realizua një raund takimesh me institucionet dhe shoqata.

Përveç takimeve, procesi i hartimit ka përfshirë faza konsultimesh me institucionet përkatëse. Gjithashtu strategjia, përpara përfundimit të saj është diskutuar në tre takime të GTNP.

Dokumenti paraprak i strategjisë u rishikua edhe nga një ekspert ndërkombëtar i kontraktuar nga Këshilli i Evropës.

Në hartimin e Strategjisë, ndër të tjera, janë marrë në konsideratë edhe dy elementë të tjerë të rëndësishëm siç janë: harmonizimi me dokumente të tjerë strategjikë¹ dhe i është kushtuar një vëmendje e veçantë rolit të sektorit privat, si një faktor shumë i rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Strategjia si një dokument gjithëpërfshirës harmonizohet me gjetjet dhe konkluzionet e vlerësimit kombëtar të rrezikut të PP/FT, por këto gjetje dhe konkluzione vendosen në një kontekst më të shtrirë në kohë dhe në terma makro duke synuar identifikimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike afatmesëm dhe afatgjatë për periudhën 2024 – 2030.

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2020-2030- VKM ne.88, datë. 22.03.2023 SKZHIE 2022-2030
Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2023-2028-. SSK LIGJ Nr. 14/2024
Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027
Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2023-2025
Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i veprimit
Strategjia Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025 dhe plani i veprimit
Programi i Reformave Ekonomike (ERP) 2024-2026
Dokumenti i politikave prioritare 2024-2026

II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REGJIMIT TË PPP/FT NË SHQIPËRI

2.1 Kuadri ligjor për pastrimin e parave

Vepra penale e pastrimit të parave është e parashikuar në Kodin Penal që në vitin 1995. Për vetë rrezikshmërinë dhe veçoritë që ka kjo veprë penale, është përfshirë në Kreun VIII të Kodit Penal “Krime kundër autoritetit të shtetit”, Seksionin III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, së bashku, me vepra si: ‘Prodhimi e trafikimi i lëndëve narkotike apo armëve’, ‘Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale’, etj., pasi në fakt me kategorizimin në këtë seksion synohet që të mbrohet një e mirë e përgjithshme dhe shumë e rëndësishme, që është autoriteti i shtetit, mosrespektimi i të cilit sjell pasoja veçanërisht të dëmshme për tërësinë e qytetarëve të vendit.

Në vitet në vijim, parashikimi ligjor i veprës penale të pastrimit të parave është ndryshuar disa herë (2001, 2003, 2004, 2007, 2012 dhe 2013) kryesisht si rrjedhojë e përafrimit me konventat e ratifikuara, por edhe nevojat e brendshme.

Neni 287 aktualisht në fuqi është si vijon:

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- d) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;
- e) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- f) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

- a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;
- b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;
- c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;
- d) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;
- e) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Neni 287, detajon të gjitha rastet që mund të konsiderohen pastrim parash dhe shprehimisht dënon edhe vetëpastrimin. Nga vlerësimet e organizmave ndërkombëtare, parashikimi ligjor i veprës penale të pastrimit të parave është në përputhje me standardet dhe konventat e fushës.

2.2 Kuadri ligjor për financimin e terrorizmit

Në lidhje me financimin e terrorizmit, dënimi i tij fillimisht është parashikuar në vitin 2003, duke shtuar në Kod Penal nenin 230/a, si dhe një sërë nenesh të tjera 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d që kane lidhje me ndihmesën që në forma të ndryshme mund t'i jepej terrorizmit.

Në vijim neni 230/a u ndryshua sërish, duke përthithur në të edhe nenin 230/d (Grumbullimi i fondeve për financimin e Terrorizmit) dhe duke bërë disa përmirësime të mëtejshme për t'iu përafëruar konventave të fushës. Aktualisht neni 230/a, duke përfshirë edhe shfuqizimin e dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, ka këtë përmbajtje:

Neni 230/a

Dhënia ose grumbullimi i fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren ose duke ditur se ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht:

- a) për të kryer vepra me qëllime terroriste;
- b) nga një organizatë terroriste;
- c) nga një terrorist i vetëm; dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Dispozitat e këtij neni zbatohen:

- a) për të gjitha fondet, ku përfshihen pasuri të çdo lloji, të trupëzuara ose të patrupëzuara, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit të tyre, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo lloji, edhe në formë elektronike ose digjitale, që tregojnë të drejta ose interesa mbi pasuri të tilla, përfshirë kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë,

bonot, çeqet e garantuara bankare, letrat e kreditit, si dhe çdo instrument tjetër financiar, të ngjashëm me to;

- b) pavarësisht nëse personi që kryen një nga veprat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, ndodhet në të njëjtin shtet a në një shtet të ndryshëm nga ai, në të cilin ndodhet organizata terroriste a terroristi i vetëm ose nga shteti në të cilin është kryer a do të kryhet vepra me qëllime terroriste;
- c) në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, pavarësisht nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer veprën ose veprat, për të cilat ishin dhënë ose grumbulluar, apo nëse mund të vendoset një lidhje mes fondeve dhe një apo më shumë veprave konkrete me qëllime terroriste.

Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Gjithashtu Kodi Penal i Shqipërisë parashikon një sërë veprash të tjera të lidhura me terrorizmin apo financimin e terrorizmit si: ‘Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin’ neni 230/b, ‘Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit’ neni 231, ‘Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste’ neni 232/a, ‘Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj’ neni 265/a, ‘Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj’ neni 265/b, parashikime të cilat kanë pasur një efekt frenues.

Konventat Ndërkombëtare të Fushës

Republika e Shqipërisë në vijimësi ka aderuar gjithashtu në konventat ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, terrorizmit dhe financimit të tij. Konventat kryesore që veçohen janë:

- Konventa Evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” ratifikuar me Ligj nr. 8646, datë 20.7.2000 (e njohur si Konventa e Strasburgut);
- “Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” (dhe dy protokollat shtesë të saj) ratifikuar me Ligj nr. 8920, datë 11.7.2002 (e njohur si Konventa e Palermos);
- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope ratifikuar me Ligj nr. 8722, datë 26.12.2000;
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” ratifikuar me Ligj nr. 9646, datë 27.11.2006 (e njohur si Konventa e Varshavës);
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin e terrorizmit” ratifikuar me Ligj nr. 9641, datë 20.11.2006;

Ratifikimi i konventave të mësipërme e vendos vendin tonë përpara detyrimeve shtesë, pasi këto instrumente janë tanimë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm.

2.3 Ligje me karakter administrativ për parandalimin e PP/FT

Për sa i përket ligjeve me karakter administrativ që shërbejnë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë si vijon:

- Ligji nr. 9917/2008 “*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*”, i ndryshuar, i cili ka për qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe produkteve që burojnë nga veprat penale si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit;
- Ligji nr. 157/2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, i ndryshuar, i cili parashikon të gjithë mekanizmat ligjore për parandalimin dhe goditjen e veprimtarive të terroristëve, atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin apo të atyre për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, duke ndërmarrë veprimet e bllokimit dhe sekuestrimit të fondeve e pasurive, në zbatim të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në këtë kuadër, në vendin tonë zbatohen plotësisht rezolutat e KS të OKB, si: Rezoluta 1267 (1999), 1373 (2001), rezolutat pasuese të tyre dhe ato të miratuara në vitet në vijim, si: 1452 (2002), 1989 (2011), 2178 (2014), 2242 (2015), etj., të cilat kanë për qëllim përditësimin e listave të personave të shpallur me vendime të Këshillit të Ministrave, sekuestrimin e fondeve, ndalimin e hyrjes në vend për personat e shpallur, etj.


Masat e përkohshme që parashikohen të merren me ligjin nr. 157/2013 të sipërpërmendur nuk varen nga ato që mund të merren në kuadrin e procedimeve penale apo pasurore. Nga ana tjetër, këto masa të përkohshme, nuk pengojnë zbatimin e dispozitave procedurale penale apo atyre pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas procedurave përkatëse.

Veçanti e këtij ligji është edhe parashikimi në thelb i dy procedurave të shpalljes si financues terrorizmi: e para, që ka të bëjë me aplikimin e detyrimeve që rrjedhin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe e dyta është një procedurë e brendshme shpalljeje që mund të marrë indicje nga organet përkatëse të ngarkuara për parandalimin dhe luftën kundër financimit të terrorizmit dhe që bëhet efektive pas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

Ligjet e sipërpërmendura janë ndryshuar disa herë, duke marrë për bazë vlerësimin e MONEYVAL, Direktivat e BE, por edhe nevojat e vendit dhe aktualisht vlerësohet se janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.4 Funksionimi i sistemit të parandalimit dhe luftës ndaj PP/FT

Sistemi i parandalimit dhe luftës ndaj PP/FT në Shqipëri operon bazuar në tre shtylla të pavarura, secila me rëndësi thelbësore, por në ndërveprim aktiv reciprok me njëra tjetrën. Këto tre shtylla punojnë së bashku si në aspektin parandalues, por edhe për të mbështetur edhe luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimet e tjera si evazioni fiskal, korrupsioni, krimi kibernetik, trafiku i drogës dhe mashtrimi. Regjimi balancon objektivat duke synuar ruajtjen e integritetit të sistemit financiar të Shqipërisë dhe duke garantuar sigurinë e shtetasve shqiptarë, duke respektuar të drejtat dhe liritë individuale, përfshirë ato të privatësisë.



1) **Parandalimi dhe zbulimi** ka si synim mbikëqyrjen dhe zbatimin e përputhshmërisë me PPP/FT dhe mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e inteligjencës financiare dhe informacioneve të tjera.

AIF ushtron funksionet si autoritet përgjegjës dhe si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit². Gjithashtu, kjo agjenci funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

AIF shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit, autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës dhe me çdo agjenci të huaj homologe, në varësi të detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit.

Kur ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për PP/FT, AIF urdhëron monitorimin e llogarive apo veprimeve bankare për një periudhë të caktuar, apo bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë.

Përveç kësaj, AIF kryesisht, mbi bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, apo për rastet e kërkuara nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar, organizma të tjerë ndërkombëtarë, nga të cilët lindin detyrime për Republikën e Shqipërisë, nxjerr listën e vendeve për kufizimin dhe/ose kontrollin e transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit të subjekteve, proporcionalisht me rreziqet e evidentuara, vendime këto të detyrueshme për zbatim nga subjektet dhe autoritetet shtetërore që kanë detyrime sipas këtij ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Përveçse më sipër, AIF ushtron edhe funksione mbikëqyrëse, edhe pse jo si objekt kryesor veprimtarie, në lidhje me përputhshmërinë e zbatimit të detyrimeve ligjore për subjektet që i nënshtrohen ligjit të PPP/FT.

- Roli mbikëqyrës kryesor iu besohet një sërë institucionesh si p.sh: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike etj...³. Funksionet kryesore të autoriteteve mbikëqyrëse, për veprimtaritë nën juridiksionin

² Neni 21 “Organizimi i autoritetit përgjegjës”..... 2. Në zbatim të këtij ligji, Agjencia e Inteligjencës Financiare shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.;.....

³ Neni 24 “Funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse “ 2. Autoritetet mbikëqyrëse mbikëqyrin, nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet e parashikuara në këtë ligj. Për qëllimin e këtij ligji, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të këtij ligji.

e tyre, kontrollojnë zbatimin e programeve të luftës kundër PP/FT nga subjektet dhe sigurohen se këto programe janë të përshtatshme;

- informojnë dhe bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës, për çështjet e mospërputhshmërisë, rezultatet e inspektimeve të tyre, masat përmirësuese që do të merren dhe masat administrative;
- ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar që një person i papërshtatshëm të zotërojë, të kontrollojë ose të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në drejtimin, administrimin ose veprimtarinë e një subjekti;
- bashkëpunojnë dhe ofrojnë asistencë të specializuar, sipas veprimtarisë së tyre, në fushën e PP/FT, në përputhje me kërkesat e autoritetit përgjegjës;
- bashkëpunojnë për përgatitjen dhe shpërndarjen e programeve të trajnimit në fushën e PPP/FT;
- mbajnë statistika për veprimet e ndërmarra, si dhe për sanksionet e vendosura.

Në plotësim të hallkave të mësipërme, sistemi përbëhet edhe nga një numër i konsiderueshëm subjektësh (kryesisht private, por jo vetëm) si p.sh: bankat, zyrat e këmbimit valutor, institucionet financiare jo banka, fondet e pensionit, noterët, avokatët, firmat e ndërtimit, lojërat e fatit, kazinotë, audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, agjentët e pasurive të paluajtshme etj., të cilët kanë një sërë detyrimesh ligjore si raportimi i rasteve të dyshimta te autoriteti përgjegjës dhe ushtrimi i vigjilencës së duhur, të thjeshtuar apo të zgjeruar ndaj klientëve të tyre.

Paralelisht me këto masa subjektet kanë detyrim për të ndërmarrë masa parandaluese si p.sh.: hartimi dhe zbatimi efektiv i rregulloreve/udhëzimeve të brendshme të cilat, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e subjektit, parashikojnë marrjen e masave të përshtatshme për të kuptuar rrezikun e PP dhe të FT dhe zbutur ato.

Gjithashtu ata duhet të:

- caktojnë një person përgjegjës për PP/FT në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, të cilat të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për PP/FT;
- krijojnë një sistem të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;
- trajnojnë punonjësit për PP/FT përmes organizimit periodik të programeve të kualifikimit;
- kryejnë vlerësime risku të brendshme, duke përfshirë riskun e biznesit përkatës dhe atë të klientëve⁴.

⁴ Neni 11 "Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet".

Detyrime të posaçme për raportim kanë edhe organet doganore, tatimore, ASHK si dhe çdo autoritet që regjistron, licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e OJF.

- 2) **Hetimi** ka si objekt identifikimin, hetimin, ndjekjen penale, dënimin e krimeve të PP/FT dhe konfiskimin e pasurisë kriminale.

Në plotësim të sistemit parandalues të përshkruar më sipër, shtylla tjetër po aq e rëndësishme është edhe ajo që mund të quhet sistemi i luftës ndaj PP/FT që përbëhet nga organet e zbatimit të ligjit siç janë Policia e Shtetit, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe SPAK. Këto organe kanë si objekt të veprimtarisë së tyre hetimin dhe dërgimin përpara përgjegjësisë të subjekteve të dyshuara për PP/FT dhe konfiskimin e pasurisë. Të dyja hallkat (ajo parandaluese me atë luftuese) veprojnë në mënyrë të pavarur, por në të njëjtën kohë shkëmbejnë dhe ndajnë informacione, duke pasur bashkëveprim aktiv me njëra-tjetrën.

- 3) **Politika dhe koordinimi** ka si synim vlerësimin e rreziqeve të PP/FT, zhvillimin e politikave vendase dhe ndërkombëtare, dhe koordinimin ndërinstitucional.

Krahas autoriteteve dhe subjekteve të përmendura më sipër, të cilët kanë një rol thelbësor dhe operacional në parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT, arkitektura e sistemit plotësohet me Komitetin e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), i cili është organi i nivelit më të lartë përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër PP/FT.

Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka ministrat përgjegjës për:

- financat;
- punët e jashtme;
- çështjet e mbrojtjes;
- rendin dhe sigurinë publike;
- çështjet e drejtësisë.

Anëtarë të Komitetit janë edhe Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Komiteti mund të krijojë grupe pune teknike dhe/ose operationale për të ndihmuar në kryerjen e funksioneve që ka, si dhe për studimin e tipologjive e të teknikave të PP/FT. Në mbledhjen e KBLKPP në datën 27.12.2023, krahas miratimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut si dhe planit të veprimit përkatës, Grupit Teknik Ndërinstitucional i Punës është riformatuar, duke përfshirë në nëngrupe pune edhe përfaqësues nga subjekte private, sipas fushave përkatëse.

GTNP, i cili mblidhet periodikisht, angazhohet edhe në përgatitjen e strategjive si dhe në funksion të vlerësimeve nga organizmat ndërkombëtare të fushës, siç është Komiteti Moneyval.

III. FAKTORËT KRYESORË KONTRIBUES NË FORMULIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PPP/LFT

Shqipëria është e angazhuar në nivel politik, qeverisës dhe institucional në parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe aktivitetet e lidhura me financimin e terrorizmit. Pastrimi i parave vlerësohet si një kërcënim për sigurinë e shoqërisë, integritetin e sistemit financiar, stabilitetin e ekonomisë dhe rritjen e qëndrueshme të saj.

Shqipëria ka krijuar një kuadër ligjor të përshtatshëm për këtë fushë, në përputhje me Rekomandimet e FATF, si dhe ka strukturat institucionale të duhura që përfshijnë një gamë të gjerë autoritetesh kompetente për të parandaluar, mbikëqyrur, zbuluar, hetuar PP/FT dhe konfiskimin e pasurive.

Rezultatet e arritura kanë qenë produkt i një pune të vazhdueshme dhe rrugëtimi të shtrirë në kohë, duke përmirësuar në mënyrë graduale si aspektet e përputhshmërisë teknike të bazës ligjore me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare të fushës, ashtu edhe efektivitetin e zbatimit të tyre.

Në vijim të vlerësimit të fundit nga komiteti Moneyval (2018), Shqipëria u fut në të ashtuquajturën listë gri (2020), nga ku doli në vitin 2023 si pasojë e zbatimit dhe përmirësimit të një sërë masash e rekomandimesh të përcaktuara nga organet monitoruese ndërkombëtare. Pavarësisht kësaj, ndonëse janë bërë shumë hapa pozitive si në kuadrin ligjor, ashtu edhe në zbatimin efektiv të tij, mbeten ende disa faktorë që kërkojnë adresim në vitet në vijim. Vlen të evidentohet se edhe standardet referuese ndërkombëtare (të FATF apo të BE) pësojnë ndryshime të vazhdueshme, për rrjedhojë ndjekja e tyre, përafrimi dhe monitorimi i zbatimit mbeten synim i vazhdueshëm për vendin tonë.

Formulimi i kësaj strategjie vjen edhe si rezultat i nevojës për adresimin e këtyre rekomandimeve/standardeve, gjetjeve të vlerësimit kombëtar të riskut dhe planit të veprimit për adresimin e risqeve të PP/FT, vizionit të vendit për arritjen e objektivave Shqipëria 2030, adresimit të sfidave të sigurisë kombëtare dhe rolit të Shqipërisë në rajon dhe në rrafshin ndërkombëtar.

Kjo strategji synon të ndihmojë veç të tjerash edhe procesin e vlerësimit të radhës nga Komiteti Moneyval (2025), duke ndërgjegjësuar më mirë e koordinuar me tej aktorët e përfshirë në parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT, me synim pasqyrimin sa më të plotë të punës dhe masave të marra nga vendi ynë.

Përveçse sa më sipër, faktorët kryesorë thelbësorë mbi të cilët bazohet nevoja e hartimit të strategjisë mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Roli në rritje i Shqipërisë në komunitetin ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me vendet përkatëse diktojnë nevojën për zbatimin efektiv të rekomandimeve të FATF, por edhe ato të BE në fushën PPP/FT;
- Integrimi i vendit në tregjet ndërkombëtar të kapitalit, globalizimi i sistemeve tregtare dhe financiare, zhvillimet teknologjike;
- Lëvizja e lirë e njerëzve, e mallrave dhe e shërbimeve krijon edhe hapësira për aktivitete kriminale;
- Zhvillimet gjeopolitike dhe efektet që ato kanë për vendin tonë.

Këta faktorë përveç kushteve zhvillimore dhe progresit për vendin, shoqërohen dhe me rreziqe dhe mundësi për krime financiare, pastrim parash dhe financim të aktiviteteve të lidhura me terrorizmin dhe si rrjedhim është e domosdoshme që përveç ndërgjegjësimit të ketë edhe një plan veprimi me objektiva, detyra dhe masa konkrete të matshme për çdo aktor të përfshirë në parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT.

3.1 Mangësitë e identifikuara nga organet monitoruese/vlerësuese

Në tetor 2017 nisi procesi i vlerësimit nga Moneyval, i cili u finalizua me miratimin e Raportit të ndërsjellë të vlerësimit (MER) në korrik 2018. Vlerësimi i Moneyval përqendrohej në raportimet e shteteve në lidhje me përputhshmërinë teknike të kuadrit ligjor të vendit me 40 Rekomandimet e FATF dhe efektivitetin e masave të marra në kuadër të sistemit parandalues të PP/FT. Vlerësimi bazohej mbi të dhënat për periudhën 2011-2017.

Si rezultat i vlerësimit u konkludua se nga 40 Rekomandime të FATF Shqipëria kishte:

- 1 Rekomandim të pa përputhur (NC);
- 10 Rekomandime të përputhur pjesërisht (PC);
- 27 Rekomandime të përputhur gjerësisht (LC);
- 2 Rekomandime të përputhur (C).

Për sa i përket vlerësimit të efektivitetit, nga 11 Rezultate imediate (IO):

- 2 IO ishin me efektivitet të ulët (LE);
- 7 IO ishin me efektivitet të moderuar (ME);
- 2 IO ishin me efektivitet substancial (SE).

Në vijim të këtij vlerësimi, vendi u vendos në monitorim të përforcuar nga Moneyval, si dhe në vitin 2020 u vendos nga FATF në listën e vendeve në monitorim/“lista gri”.

Në këtë kuadër, Shqipëria ndërmori menjëherë një angazhim të nivelit të lartë politik për të bashkëpunuar me FATF dhe MONEYVAL për të forcuar efektivitetin e sistemit parandalues të

PP/FT nëpërmjet dakordësimit të një plani veprimi të përbërë nga 19 pika veprimi, me afat zbatimi brenda një periudhe 3 vjeçare.

Për ndjekjen dhe zbatimin e planit të veprimit u ngrit grupi ndërinstitucional i punës me Vendimin e Komitetit të Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, nr. 1 datë 19.02.2020 “*Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar*”. Ky grup pune drejtohej nga Zëvendëskryeministri, me përbërjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit. AIF kishte rolin e sekretarit teknik për asistimin e grupit të punës.

Në tërësinë e tij plani i veprimit i dakordësuar prej Shkurt 2020 nuk pati ndryshime në përmbajtjen e tij, përveç zgjatjes së afatit të përmbushjes së planit të veprimit me 6 (gjashtë) muaj, që u ndikua edhe nga vështirësitë që solli pandemia globale COVID-19.

Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit realizohej mbi baza 4 mujore. Për gjithë procesin Shqipëria dërgoi 10 (dhjetë) raporte progresi pranë ICRG/FATF, ku më i fundit ishte ai i dërguar në datë 21 Korrik 2023. Ky raportim i fundit ishte një përmbledhje e punës 3 vjeçare të bërë nga të gjitha institucionet përgjegjëse në lidhje me zbatimin e planit të veprimit.

Në plenaren e Tetor 2023 FATF miratoi përmbushjen e planit të veprimit nga Shqipëria duke evidentuar ndërmarrjen e një sërë nismash ligjore dhe reformash të cilat ndikuan ndjeshëm në rritjen e efektivitetit të sistemit parandalues të PP/FT. Këto masa çuan në daljen nga “lista gri” e FATF.

Në deklaratën publike të FATF për daljen nga lista, përveç evidentimit të qartë të progresit të arritur dhe përgëzimit të Shqipërisë, evidentohet edhe se “*FATF mirëpret angazhimin e Shqipërisë për të respektuar parimet e FATF në rast se Shqipëria prezanton një program amnistie fiskale në të ardhmen*”, si dhe kërkon që Shqipëria “*të vazhdojë të punojë me MONEYVAL për të mbështetur përmirësimet në sistemin e saj PPP/FT*”.

Në raportin e vlerësimit të Grupit të Përbashkët (Joint Group – JG) të ICRG/FATF, janë propozuar disa rekomandime, pavarësisht se nuk janë teknikisht të detyrueshme, por që duhet të mbahen në vëmendje nga Shqipëria në përmirësimin e mëtejshëm të sistemit parandalues të PP/FT dhe armëve të shkatërrimit në masë, si më poshtë vijon:

- Nëse Shqipëria do të hartojë në të ardhmen një program mbi amnistinë fiskale, JG inkurajon Shqipërinë të punojë me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar që çdo program i tillë të jetë në përputhje me parimet dhe praktikën më të mira të FATF-së për programet e amnistisë fiskale (VTC programme).
- Inkurajohet Shqipëria të arrijë progres të mëtejshëm në ndjekjen e më shumë hetimeve penale dhe ngritjen e akuzave për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale (pastrimin e parave) në lidhje me rreziqet e larta të identifikuar për pastrim parash si korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafikimi i narkotikëve, me fokus të veçantë rastet kur vepra penale mëmë të jetë kryer në juridiksion të huaj.

- Inkurajohet Shqipëria të arrijë progres të mëtejshëm nëpërmjet një koordinimi më të gjerë ndërinstitucional për të vlerësuar kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për të zhvilluar politika dhe strategji për të adresuar këto kërcënime. SPAK duhet të përfshihet plotësisht në këto përpjekje.
- Kërkohej nga Shqipëria që të ngrejë dhe të zbatojë një sistem të menaxhimit të rasteve me qëllim zëvendësimin e sistemit aktual të përdorur nga prokurorët për të menaxhuar dhe ndjekur ecurinë e rasteve.
- Shqipëria duhet të investojë në burime, njerëzore dhe teknologjike, në luftën kundër kërcënimeve të reja në fushën e pastrimit të parave (p.sh., krimi kibernetik, asetet virtuale, etj.).

Rekomandimet e mësipërme janë pranuar nga organet shqiptare dhe janë tanimë pjesë e planeve të veprimit dhe punës, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Siç është evidente nga këto rekomandime, fusha me potencial më të lartë shqetësues, përveç asaj për amnistinë fiskale, është ajo që lidhet me ndjekjen penale. Në të njëjtin drejtim shkojnë edhe rekomandimet e BE në kuadër të progres raporteve, apo edhe mekanizmave të tjerë siç janë “Road map” dhe “Growth Agenda”.

Aktualisht përputhshmëria teknike – pra e kuadrit ligjor lidhur me 40 rekomandimet e FATF, sipas vlerësimit të Moneyval, paraqitet si më poshtë:

- 6 Rekomandime të përputhura (C);
- 31 Rekomandime “gjerësisht të përputhura” (LC);
- 2 rekomandime “pjesërisht të përputhura” (PC);
- 1 rekomandim “i pa zbatueshme” (N/A);
- Asnjë rekomandim “i pa-përputhur” (NC).

Lidhur me dy rekomandimet që janë ende “pjesërisht të përputhura” (PC):

- Rekomandimi 7 “Masat shtrënguese ndërkombëtare për financimin e armëve të shkatërrimit në masë”: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë hartuan dhe bashkë propozuan projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në RSH”, miratuar në seancën plenare të Kuvendit të datës 14 Dhjetor 2023. Me miratimin e ndryshimeve të ligjit 72/2019 besojmë se vendi i ka përmbushur kriteret për rritje të këtij rekomandimi, mirëpo aplikimi për rritjen e vlerësimit të këtij rekomandimi nuk është i mundur për shkak se në vitin 2025 pritet të fillojë raundi i ri i vlerësimit të Shqipërisë nga Moneyval.
- Rekomandimi 15 “Teknologjitë e reja - ofruesit e mjeteve virtuale”: Në lidhje me këtë rekomandim synohet një përmbushje sa më e shpejtë dhe ka filluar puna në koordinim të plotë me institucionet përgjegjëse, si dhe me mbështetjen përmes ekspertizës të ofruar në kuadër të “Projektit kundër krimit ekonomik në Shqipëri” (AEC-AL), program i përbashkët i

Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Vlerësohet se për R.15 mbeten ende të nevojshme zhvillime, për të arritur përmbushjen e rekomandimit.

3.2 Politikat dhe planet përkatëse të nivelit të lartë

Shqipëria mbetet e angazhuar në adresimin e sfidave dhe rekomandimeve që rrjedhin si pasojë e detyrimeve ndërkombëtare që lidhen me parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT. Gjithashtu, në koordinim dhe harmonizim edhe me planet dhe strategjitë e tjera sektoriale të sigurisë kombëtare, luftës ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, informalitetit etj., janë adresuar dhe do vijohet të adresohen një sërë mangësish, duke arritur rezultate të prekshme dhe konkrete.

Në zbatim të SKZHIE 2022-2030 dhe Strategjive të tjera e planeve të veprimit që ndërthuren me këtë Strategji, është miratuar Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024–2026, si dhe Dokumenti i Politikave Prioritare 2025-2027.

Disa nga aktet me rëndësi në PKIE 2024-2026 janë si më poshtë:

- projektligji “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”
- projektligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”
- projektligj “Për sigurinë kibernetike”
- projektligji “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”
- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”
- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 “Për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

Në dokumentin e politikave prioritare për vitet 2025-2027, ritheksohet se Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në lidhje me prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me reformën gjyqësore, politikën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administratën publike si prioritete në kuadër të negociatave të grup kapitujve themelore dhe atyre të aderimit në përgjithësi. Në përparësitë afatshkurtra dhe afatmesme të Qeverisë ndër të tjera janë të përfshira:

- Lufta kundër korrupsionit
- Digjitalizimi

Siç u përmend më sipër, adresimi i mangësive të evidentuara, solli si pasojë daljen nga lista gri. Pavarësisht kësaj, procesi i adresimit të problematikave dhe mangësive do vijojë të ketë vëmendje të posaçme nga Qeveria si dhe organet e pavarura (hetimore, mbikëqyrës etj), duke

synuar përputhshmërinë maksimale ligjore dhe rritje të mëtejshme të efektivitetit me rekomandimet dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të Shqipërisë.

Disa nga nismat/masat e adresuara të lidhura me parandalimin e PP/FT, hetimin e tyre apo edhe në fusha të lidhura me këto veprimtari, gjatë viteve të fundit janë si më poshtë:

Nisma të lidhura me efektivitetin e hetimeve:

- Progres pozitiv i përgjithshëm në zbatimin e reformës në drejtësi, proces i cili besohet se ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe me progresin në fushën e hetimeve, sekuestrimeve dhe konfiskimeve në vend;
- Krijimi i regjistrit për administrimin dhe inventarizimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, për hetimet e kryera në kuadër të proceseve penale apo atyre pasurore;
- Krijimi dhe funksionimi i një sistem të ri elektronik për letër porosite pranë Ministrisë së Drejtësisë, për të menaxhuar dhe prioritetuar rastet hyrëse dhe dalëse, përfshirë dhe kërkesat në pritje;
- Krijimi dhe funksionimi i sistemit “Presto” pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i cili mundëson mbledhjen e të dhënave statistikore të detajuara, përfshirë gjurmimin e tipologjive dhe trendeve të veprës penale të pastrimit të parave të parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal dhe hetimeve pasurore në baze të ligjit antimafia. Ndërkohë vlen të evidentohet se hedhja e të dhënave në këtë regjistër duhet të përmirësohet;
- Miratimi i akteve nënligjore specifike për rritjen e cilësisë së hetimeve proaktive si Udhëzimi nr. 10 datë 10.07.2020 i Përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm, ngritja e seksioneve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për luftën kundër pastrimit të parave, miratimi i Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020 “Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës Kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe konsolidimit të Rendit e Sigurisë Publike”, hetimet sipas të cilit janë kryer kryesisht nga SPAK;
- Rritja e treguesve të lidhur me sekuestrimet dhe/ose konfiskimet, hetimeve financiare dhe pasurore;
- Rritja e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të ofruara qoftë me trajnimin vazhdues nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës por dhe atyre të ofruara nga asistencën ndërkombëtare (BE dhe SHBA).

Nisma të lidhura me formalizmin e ekonomisë:

- Digjitalizimi i një sërë shërbimesh publike dhe financiare. Kjo shkon paralelisht edhe me përpjekjet e Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë për të rritur digjitalizimin e shërbimeve të pagesave, të cilat tashmë kanë rritur ndjeshëm përdorimin e kartave të pagesave;

- Implementimi i projektit të fiskalizimit si një masë e re për të adresuar informalitetin;
- Rritja e vazhdueshme e përdorimit të pagesave elektronike;
- Konsolidimi i mëtejshëm i kalimit të transaksioneve për pasuri të paluajtshme përmes sistemit financiar;
- Kontrollat e ushtruara nga administrata tatimore pranë biznesit me fokus respektimin e detyrimeve për kryerjen e transaksioneve në përputhje me legjislacionin tatimor.

Ndryshime ligjore:

- Miratimi i ndryshimeve në ligjin për parandalimin dhe pastrimin e parave me qëllim për afrimin me direktivat e lidhura të BE;
- Miratimi i Ligjit “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”;
- Miratimi i Ligjit “Për regjistrin e pronarëve përfitues”;
- Miratimi i Ligjit “Për regjistrin e centralizuar të llogarive bankare”;
- Ndryshimi i ligjit “Për Noterinë” në të cilat janë parashikuar kërkesa specifike në mënyrë që të parandalohet hyrja në këto profesione e personave të përfshirë në aktivitet kriminal apo që kanë lidhje të mundshme kriminale;
- Ndryshime ligjore në fushën e regjistrimit të biznesit në QKB, me synim rritjen e besueshmërisë së të dhënave të paraqitura për personin juridik/tregtar si vendosja e afateve kohore për njoftimin e ndryshimit të ortakut, njoftimin e listës së plotë të aksionarëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative së bashku me bilancin vjetor kontabël, vendosjen e parashikimeve për masa administrative në rast mos respektimi të këtyre detyrimeve;
- Miratimi i një ligji të ri për regjistrimin e OJF, me synim konfirmimin dhe saktësimin e atyre që ushtrojnë aktivitet dhe çregjistrimin e të tjerave jo më aktive apo që nuk kanë ushtruar aktivitet;
- Miratimi i një kuadri ligjor dhe nisma për një sistem elektronik të ankesave në sektorin e prokurimeve publike, me qëllim rritjen e transparencës.

Digjitalizim i DB dhe regjistra të rinj:

- Ngritja dhe funksionimi i regjistrin të centralizuar të llogarive bankare;
- Ngritja dhe funksionimi i regjistrin të pronarit përfitues;
- Progres të dukshëm në numrin e pronave të regjistruara, me 100% (në zona urbane) dhe 92 % (në zona rurale) të pronave të digjitalizuara.

Këto nisma, përveçse kontribuojnë në formalizimin e përgjithshëm të ekonomisë si dhe aksesit në të dhëna nga organet tatimore, rritin gjithashtu mundësitë e verifikimeve në kohë dhe më të sakta nga AIF dhe Agjencitë e Zbatimit të Ligjit (AZL), duke ofruar të dhëna të shpejta dhe më të besueshme/sakta për llogaritë bankare, pronësinë përfitues, zotëruesit e pasurive të paluajtshme.

Sistemi parandalues:

- Rritja e numrit dhe larmishmërisë së RAD të dërguara nga subjektet e ligjit;
- RAD e dërguara nga subjektet e ligjit përkohë me rreziqet e evidentuara në nivel vendi;
- Rritja e përputhshmërisë me kërkesat ligjore nga ana e subjekteve kryesisht financiare, por rritja e dukshme edhe e atyre jo financiare;
- Rritja e ndërgjegjësimit përmes trajnimeve, tipologjive etj...;
- Konsolidim i mëtejshëm i mbikëqyrjes mbi bazë risku.

Rritja e përputhshmërisë me standarde ndërkombëtare:

- Në vlerësimin më të fundit të vitit 2023, Shqipëria nga 40 Rekomandimet e FATF, arriti të sigurojë rritjen e vlerësimit për dy rekomandime, duke e afirmuar vlerësimin për 37 rekomandime në total si rekomandime gjerësisht të përputhura dhe të përputhura (LC/C), 1 rekomandim ka qenë i pa aplikueshëm (NA) në kohën e vlerësimit dhe 2 rekomandimeve pjesërisht përmbushura (PC), por që synohen të përmbushen në ciklin e radhës së vlerësimit;
- Përparimi në mënyrë të qëndrueshme në zbatimin e Planit të Veprimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF);
- Përafrimi i Ligjit PP/FT me direktivat përkatëse të BE.

Në të ardhmen do të vijojnë të mbeten prioritetet e qeverisë lufta kundër korrupsionit, krimin të organizuar, terrorizimit, ekstremizmit të dhunshëm, reduktimi i ekonomisë informale si dhe zbatimi i plotë i reformës në drejtësi.

3.3 Rezultatet e Vlerësimit Kombëtar të Riskut

Në zbatim të detyrimeve ligjore të brendshme, rekomandimeve të FATF, detyrimeve në kuadër të ratifikimit të konventave të fushës apo edhe direktivave të BE mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të PP/FT, gjatë vitit 2023 është kryer Vlerësimi Kombëtar i

Riskut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në vendin tonë, i cili përbënte të katërtin e këtij lloji që prej vitit 2012.

Vlerësimi i fundit në vitin 2019 u krye me një metodologji të zhvilluar së brendshmi nga organet e përfshira, ndërsa këtë herë është vendosur të zbatohet metodologjia e Këshillit të Evropës, e vlerësuar si e përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për realizimin e këtij procesi.

AIF ka luajtur rolin koordinues në realizimin e Vlerësimit Kombëtar të Riskut ndërkohë që ky dokument është bazuar në kontributet e një sërë institucionesh publike (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Tatimeve, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare etj.) dhe të subjekteve private (banka, shoqëri transfertash, kontabilist etj.). Ky vlerësim ka marrë në konsideratë edhe kontekstin e të dhënave relevante nga raporte ndërkombëtare dhe kombëtare.

Nëpërmjet këtij dokumenti, synohet të sigurohet një njohje më e mirë e risqeve të PP/FT dhe marrjen e masave të përshtatshme për zbutjen e risqeve të identifikuar. Ky dokument është shoqëruar dhe me Planin e Veprimit përkatës, me masa konkrete të dakordësuara nga institucionet e përfshira në proces.

Përditësimi i Vlerësimit Kombëtar të Riskut bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të rreziqeve të PP/FT bazuar në komponentët sa vijon:

- Analiza e kërcënimeve që rrjedhin nga kriminaliteti, i cili shërben si burimi kryesor për të gjenerimin e të ardhurave kriminale;
- Analiza e personave që përfshihen në PP;
- Analiza e sektorëve ekonomikë të lidhur me PP;
- Analiza e sektorëve financiarë/të profesioneve të lira, të keqpërdorur për PP dhe FT;
- Karakteristikat ndërkufitare të PP;
- Analiza e rreziqeve të FT.

Më poshtë është paraqitur shkurtimisht një listë përmbledhëse e kategorive kryesore të rrezikut të PP të identifikuar përmes këtij vlerësimi:

1. Pastrimi i fondeve nga një sërë veprash penale të kryera jashtë vendit (vepra penale të lidhura me trafikimin e lëndëve narkotike, apo edhe vepra penale të kryera nga krimi i organizuar⁵, vjedhja e pasurisë) nëpërmjet përdorimit të sistemit financiar formal, transportit ndërkufitar të parave cash, investimeve në pasuri të paluajtshme;
2. Pastrimi i fondeve nga mashtrimet (përfshirë mashtrimet kompjuterike dhe në fushën e investimeve në “platforma” investuese të pa licencuara), të kryera jashtë vendit ose në

⁵ Kryesisht veprat penale të lidhura me krimin e organizuar janë trafikimi i lëndëve narkotike, vjedhja, mashtrimi.

Shqipëri nga individë apo grupet e organizuara kriminale përmes përdorimit të sistemit financiar me pasojë transferimin e fondeve në juridiksione të tjera, tërheqjen në para cash;

3. Pastrimi i fondeve nga krimet që lidhen me fushën e tatimeve (fshehja e të ardhurave dhe mashtrimi i TVSH), duke përdorur personat juridik rezident, duke mos deklaruar bilance dhe faturimet reale, nëpërmjet regjistrimit të personave juridik që nuk kryejnë aktivitet real në Shqipëri (shoqëri fiktive), nëpërmjet përdorimit të sistemit financiar formal, investimeve në pasuri të paluajtshme;
4. Pastrimi i të ardhurave nga korrupsioni nëpërmjet përdorimit herë pas here të palëve të treta (individë dhe persona juridik) që shërbejnë për të kamufluar mekanizmin, integrimi i mëvonshëm në instrumente financiare, pasuri të paluajtshme brenda vendit, apo biznese;
5. Pastrimi i parave duke përdorur persona juridikë rezident (kryesisht të formës shpk⁶ dhe më rrallë forma të tjera juridike) ose persona të tretë individë brenda ose jashtë rrethit të ngushtë të personit që është gjenerues i të ardhurave kriminale;
6. Përfshirja e mundshme e profesionistëve nëpërmjet dhënies së këshillave me qëllim mundësimin e procesit të pastrimit të parave.

Kategoritë e riskut për financim terrorizmi/terrorizëm të identifikuar përmes këtij vlerësimi janë si më poshtë:

1. Risku i ekstremizmit dhe radikalizmit me frymëzim ideologjik, fetar të cilat mund të mbështesin apo ushqejnë potencialisht veprimtaritë terroriste/financuese të terrorizmit;
2. Kërcënimi i mundshëm nga të rikthyerit nga zonat e konfliktit nëpërmjet përhapjes së ideologjive ekstremiste, përdorimi i përvojës së luftës në indoktrinimin e personave të tjerë, përhapja e tensioneve shoqërore⁷.

6 Nisur kjo nga fakti se kjo lloj forme regjistrimi në vendin tonë është forma më e përhapur e regjistrimit të subjekteve juridike.

7 Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe Planet e Veprimit.




Faktorët e brendshëm të kërcënimit:

Mjedisi strategjik i sigurisë, niveli rajonal. Bazuar në SSK 14/2024 dhe Strategjinë Ushtarake. Shqipëria është një vend me pozitë gjeografike të favorshme si për transportin e mallrave po ashtu njerëzve pasi shtrihet në Evropën Juglindore, në Perëndim të Gadishullit Ballkanik dhe kufizohet në veri nga Mal i Zi, në veri-lindje nga Kosova, në lindje me Maqedoninë e Veriut, në jug dhe jug-lindje kufizohet me Greqinë ndërsa në perëndim laget nga deti Adriatik dhe deti Jon. Kjo pozitë gjeografike mund të keqpërdoret për qëllime kriminale, si kontrabanda e mallrave dhe trafikimi i drogës, i qenieve njerëzore, etj.

Faktorët kontekstualë: Shumica e rreziqeve të PP/FT të përshkruara në këtë raport ndikohen nga faktorë kontekstualë, duke përfshirë nivelin e ekonomisë informale pavarësisht tendencës pozitive të uljes së tij, numri i lartë i shtetasve shqiptarë që kanë emigruar jashtë vendit duke ndikuar kështu edhe në përhapjen apo krijimin e lidhjeve të krimit ndërkombëtar.

Përditësimi aktual evidentoi se gjithashtu, në përgjithësi, aktivitetet e trafikimit të lëndëve narkotike, vepra penale të kryera në formën e krimit të organizuar, krimet tatimore, korrupsioni, mashtrimi (duke përfshirë mashtrimin kompjuterik) shfaqen si vepra penale kryesore të gjenerimit të fondeve për skemat e PP në vendin tonë.



Subjektet:

Individët rezident: Në Shqipëri vazhdojnë të jenë grupi më i madh i subjekteve të përfshira në aktivitete me potencial pastrimin e parave.

Skenarët e rrezikut më të lartë që lidhen me individët janë:

- Blerje pasurish me burim të panjohur apo të pajustificuar;
- Përfitim i transfertave të shpeshta dhe në vlera të vogla nga individë pa një lidhje të qartë mes tyre;
- Depozitimi në llogari bankare të shumave cash me burim të panjohur;
- Blerje pasurish të paluajtshme nën vlerë dhe rivlerësim brenda një kohe të shkurtër;
- Veprime financiare (depozitim/ transfertat/ investim në pasuri të paluajtshme/ luajtshme) nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale;
- Investim në vlerë të lartë në pasuri të paluajtshme nëpërmjet përdorimit të personave të tretë.

Personat juridik rezident: Vazhdojnë të përfaqësojnë numrin e dytë më të madh të subjekteve të përfshirë në aktivitetin e mundshëm të PP, kryesisht me burim të ardhurash nga krime në fushën tatimore, mashtrimi, krimi i organizuar, korrupsioni ku skenarët kryesorë përfshijnë:

- Vendosije të fondeve me origjinë të panjohur në qarkullimin real tregtar;
- Investime në pasuri të paluajtshme në emër të shoqërisë ekzistuese të zotëruar nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale në vlera të pajustificuara me burime të ligjshme;

- Përfitime të transfertave të larta në llogari biznesi të personit të dyshuar si i përfshirë në veprimtari kriminale nga shoqëri pa një lidhje të qartë mes shërbimit/mallit të ofruar dhe pagesës;
- Përfshirje e një individi të vetëm në disa subjekte të cilat kanë të njëjtin objekt veprimtari apo të njëjtën adresë dhe kryerja e transaksione pa një lidhje të qartë midis palëve të transaksionit;
- Transferta të dyshimta të përfituara në llogari të një shoqërie, që nuk ka aktivitet të mirëfilltë ekonomik;
- Përdorimi i subjekteve juridike për përfitimin e transfertave nga jashtë nëpërmjet mashtrimit ku pjesa dërmuese e fondeve kanalizohen jashtë vendit dhe një pjesë tërhiqen cash;

Individët jo rezident: Skenarët kryesorë të lidhur me këtë kategori janë:

- Krijimi dhe regjistrimi i subjekteve juridike rezidentë dhe përdorimi i llogarive të tyre bankare për marrjen apo dërgimin e transfertave nga/drejt juridiksioneve të ndryshme pa një lidhje të qartë me objektin e veprimtarisë të shoqërisë me dyshime të lidhura kryesisht me evazionin fiskal;
- Realizimi i investimeve kryesisht rezidenciale pa një burim të qartë të ardhurave.

PEP Rezident⁸: Për shkak të funksionit të tyre rastet e dyshuara të lidhura me PEP janë kur vepra të origjinës vlerësohet të ketë qenë “Shpërdorim detyre/Korrupsion” dhe ndër skenarët kryesorë janë:

- Investime në vlera të larta në një biznes mbas mbarimit të detyrës (ish PEP) pa një burim të qartë të ardhurave apo edhe deklarimi i fitimeve të larta të menjëhershme nga një biznes i zotëruar nga një ish PEP;
- Qarkullim fondesh të larta në llogaritë individuale nga PEP deklaruar nga biznesi, por të pajustificuara nga të ardhurat e biznesit;

8 Sipas nenit 2 pika 10 e ligjit PP/FT PEP do të konsiderohen: a)Individët, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarinimin e pasurive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, pavarësisht nëse kanë detyrimin për deklarinimin sipas legjislacionit në fuqi për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë; b)Individët, të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme si brenda vendit apo jashtë vendit në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, ministra, zëvendësministra ose pozicione të ngjashme me to, anëtarë të Kuvendit ose organeve legjislative të ngjashme, politikanë të lartë, anëtarë të organeve drejtuese të partive politike, gjyqtarët e gjykatave të larta ose kushtetuese, si dhe çdo gjyqtar i një gjykate, ndaj vendimeve të së cilës nuk mund të ushtrohen mjetet e zakonshme të ankimit, anëtarët e organeve drejtuese të bankave qendrore, ambasadorët dhe të ngarkuarit me punë, si dhe oficerët me gradë më të lartë në Forcat e Armatosura, drejtuesit e lartë dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive shtetërore, si dhe drejtorët, zëvendësdrejtorët ose anëtarët e bordit ose çdo pozicion tjetër i ngjashëm me to në një organizatë ndërkombëtare. Individët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike do të konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 (tre) vjet pas largimit nga funksioni.

- Investime në pasuri të paluajtshme mbas mbarimit të detyrës pa një burim të qartë të ardhurave;
- Investime në pasuri nga PEP me vlerë të deklaruar nën çmim tregu;
- Emërim fillestar i administratorëve/përfaqësuesve ligjor por edhe e ortakëve të personave juridik pa të dhëna për aktivitet kriminal, por dukshëm pa përgatitje të duhur në kulturë ekonomike apo arsimore për të zotëruar ose zhvilluar aktivitete të tilla tregtare, që zotërohen *de facto* nga PEP dhe që më pas kalohen në emër të tyre. Një pjesë e këtyre shoqërive, në raste sporadike, janë të përfshira në fushën e prokurimeve publike.

Sektorët ekonomik: Ky vlerësim identifikoi disa sektorë ekonomikë, të cilët janë të përdorur më shpesh për aktivitete të PP në faza të ndryshme. Sektorët ekonomikë më të ndjeshëm ndaj aktivitetit të PP janë: Sektori i Pasurive të Paluajtshme, Tregtia, Sektori i Shërbimeve Telematike (Call Center)⁹, konsulenca në fushën ekonomike dhe ligjore. Skemat rast pas rasti përfshijnë edhe elementë ndërkombëtarë, të krijuara qëllimisht apo edhe përfshirje të bizneseve ekzistuese, elementë të cilat synojnë të pengojnë identifikimin, gjurmimin e burimit dhe qëllimin përfundimtar të përdorimit të të ardhurave kriminale.

Përdorimi i sistemit financiar dhe jo financiar:

Për sa i përket përdorimit si kanal për rastet e dyshuara të pastrimit të parave ky vlerësim identifikoi se kanalet më të përdorur janë sistemi bankar, bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiarë (kryesisht noter).

Ky konkluzion bazohet në disa faktorë si natyra e ekonomisë të vendin tonë e cila përfshin kategori subjektsh tradicionalë dhe të përqendruar kryesisht në sektorin bankar, ndërkohë që subjektet e tjera financiare janë ende me zhvillim minimal krahasuar me bankat.

Përdorimi i sistemit bankar është i pashmangshëm në një apo më shumë faza të pastrimit të parave (vendosja, shtresëzimi, integrimi), për shkak kjo të natyrës së qenësishme të operacionit bankar, zhvillimit të tij dominues në vendin tonë krahasuar me subjekte të tjera financiare, madhësisë dhe rëndësisë së tij, si dhe për shkak të numrit të madh të klientëve apo transaksioneve të kryera në emër të tyre. Ndërsa, sektori bankar në parim ka një ekspozim të lartë ndaj rreziqeve të pastrimit të parave, vlerësohet se ka ndërgjegjësim të mirë dhe mjete të përshtatshme dhe për t'i zbuluar ato. Kjo është konfirmuar nga një nivel i lartë raportimi të RAD ndër vite jo vetëm në nivel numerik por edhe për sa i përket cilësisë së tyre. Kështu si indicie për informacionet e dërguara nga AIF në organet ligj zbatuese në 90-95% të rasteve kanë shërbyer RAD e dërguara nga sektori bankar.

Profesioni i noterit është perceptuar dhe ka rezultuar edhe nga të dhënat si më i rrezikuar krahasuar me subjektet/profesionet e tjera për shkak se noteri në Shqipëri kryen një gamë të gjerë

⁹ Në kuadër të këtij dokumenti risku i referohet subjekteve që kryesisht ushtrojnë veprimtari për investime në platforma të palicesnuara (bursa fiktive, kriptomonedha etj)

të veprimeve juridike (huadhënie, kontrata kredie, çelje trashëgimie etj.), për pjesën më të madhe e të cilave është mundësia e vetme për veprimet, përfshirë këtu edhe transaksionet e pasurive të paluajtshme.

Produktet më të përdorura:

Analizimi i të dhënave të disponueshme në kuadër të këtij vlerësimi tregoi se produktet më të përdorur për pastrimin e produkteve të veprës penale janë: transfertat hyrëse/dalëse me dhe nga jashtë vendit, tërheqje/depozitim i fondeve, transferimi i fondeve brenda vendit.

Për sa i përket përdorimit të transfertave bankare ndër karakteristikat që i bëjnë ato tërheqëse për rastet e pastrimit të parave janë: Vështirësia për të monitoruar ose kontrolluar transfertat elektronike, në nivel të njëjtë me produktet të tjera bankare për shkak të vëllimit të transaksioneve; fondet mund të transferohen përmes juridiksioneve të ndryshme, në mënyrë që të humbasin gjurmët e burimit të fondeve, apo transferimet mund të bëhen nga një numër i madh llogarish bankare në depozitat që janë krijuar për të humbur gjurmët e llogarisë kryesore shpesh të vendosur jashtë vendit.

Për sa i përket përdorimit të parasë cash ndër karakteristikat që i bëjnë ato tërheqëse për rastet e pastrimit të parave janë: fshehja e origjinës së të ardhurave dhe vështirësia në gjurmimin e këtyre të ardhurave.

Tabela për nivelin e riskut për pastrim parash sipas komponentëve të ndryshëm

Përshkrimi	Niveli i Riskut
Veprat penale të vlerësuara	
<i>Prodhim, shitje, trafikim të lëndëve narkotike dhe lëndëve psikotrope</i>	I lartë
<i>Korrupsion dhe shpërdorim detyre</i>	I lartë
<i>Krimi i Organizuar</i>	I lartë
<i>Mashtrimi</i>	I lartë
<i>Veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve</i>	I lartë
<i>Vjedhja e pasurisë</i>	Mesatar
<i>Falsifikimi</i>	Mesatar
<i>Krime në fushën doganore</i>	Mesatar
<i>Trafikim i qenieve njerëzore/ shfrytëzim prostitucioni</i>	Mesatar
Produktet Bankare	
<i>Transferta brenda dhe jashtë vendit</i>	I lartë
<i>Veprimet në cash</i>	I lartë
<i>Kredi</i>	Mesatar
<i>E-banking</i>	I ulët
<i>Garanci Bankare</i>	I ulët

<i>Blerje me kartë</i>	I ulët
Subjektet (Individë, PJ, PEP, etj.)	
<i>Individ Rezident</i>	I lartë
<i>Personat Juridik Rezident</i>	I lartë
<i>Individ jo rezident</i>	Mesatar
<i>Personat juridik jo rezident</i>	I ulët
<i>Personat e Ekspozuar Politikisht</i>	I lartë
Subjektet financiare	
<i>Banka</i>	I lartë
<i>Tregu i sigurimeve dhe Tregu i Kapitalit dhe Fondeve</i>	I ulët
<i>Shoqëritë e Transfertave</i>	Mesatar
<i>ZKV</i>	Mesatar
<i>Mjetet Virtuale</i>	Mesatar
<i>Qira Financiare</i>	I ulët
<i>Factoring</i>	I ulët
<i>SHKK</i>	I ulët
<i>Pagesat Elektronike</i>	I ulët
<i>Mikrokredi</i>	I ulët
Subjektet jo financiare	
<i>Noter</i>	I lartë
<i>Audituesit Ligjor/ Kontabilistët e miratuar</i>	Mesatar
<i>Lojërat e Fatit/Kazino</i>	Mesatar
<i>Ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme</i>	Mesatar
<i>Tregtim i mjeteve motorike</i>	Mesatar
<i>Tregtarët e gurëve të çmuar</i>	I ulët
<i>Avokat</i>	I ulët
Sektorët Ekonomik	
<i>Sektori i pasurive të paluajtshme dhe Ndërtimi</i>	I lartë
<i>Sektori i shërbimeve telematike (call center)</i>	I lartë
<i>Sektori i tregëtisë</i>	Mesatar
<i>Shërbimet e konsulencës ekonomike, ligjore</i>	Mesatar
<i>Sektori i hidrokarbureve dhe energjetikes</i>	Mesatar
<i>Sektori i Mjekësisë</i>	Mesatar
<i>Sektori i Shërbimeve</i>	Mesatar
<i>Sektori i Turizmit</i>	Mesatar
<i>Sektori i teknologjisë së informacionit</i>	I ulët

Tabela për nivelin e riskut për financim terrorizmi sipas komponentëve të ndryshëm

Përshkrimi	Niveli i Riskut
Skenarë rreziku	
<i>Ekstremizmi dhe radikalizmi të cilat mund të çojnë/ushqejnë potencialisht veprimtaritë terroriste/financuese të terrorizmit</i>	Mesatar
<i>Kërcënimin e mundshëm nga të rikthyerit nga zonat e konfliktit nëpërmjet përhapjes së ideologjive ekstremiste</i>	Mesatar
Kanale/Produkte	
<i>Transportimin e parave cash në kufi</i>	Mesatar
<i>Subjektet financiare jo bankë për shërbimin e transfertës së parave</i>	Mesatar

3.4 Konteksti ndërkombëtar

Natyra globale e kërcënimeve të PP/FT kërkon një përgjigje të koordinuar ndërkombëtare. Shqipëria punon ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe aleatët kyç për të adresuar efektivisht kërcënimet komplekse dhe në zhvillim të sigurisë, përfshirë PP/FT. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, Shqipëria dhe aleatët e partnerët e saj mund të identifikojnë më efektivisht trendët globale të PP/FT, të ndajnë informacion për të kontribuar në hetimet me elemente transnacionale dhe të zhvillojnë praktika të mira ndërkombëtare për të parandaluar, zbuluar dhe ndaluar PP/FT. Më poshtë janë disa shembuj të disa organizatave ndërkombëtare dhe partnerëve kyç për Shqipërinë në fushën e parandalimit dhe luftës ndaj PP/FT:

➤ **Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF):** FATF është mbikëqyrësi global i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ky organizëm ndërqeveritar vendos standardet ndërkombëtare që synojnë të parandalojnë PP/FT dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit të masës, si dhe dëmin që këto veprimtari të paligjshme shkaktojnë për shoqërinë. Shqipëria ka bashkëpunuar ngushtësisht me këtë organ, veçanërisht gjatë periudhës së qëndrimit-listimit-në listën gri dhe adresimit të mangësive të evidentuara.

➤ **Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL)** - Moneyval është një organizëm rajonal i asociuar i FATF dhe një organizëm monitorues i përhershëm i Këshillit të Evropës, të cilit i është i besuar detyra e vlerësimit të përputhshmërisë me standardet kryesore ndërkombëtare për luftën kundër PP/FT dhe efektshmërinë e zbatimit të tyre, si dhe me detyrën e hartimit të rekomandimeve për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre. Shqipëria është anëtare e Moneyval dhe punon në mënyrë aktive me të. Pjesëmarrja në këtë organizëm i

mundëson Shqipërisë të monitorojë trendet dhe tendencat më të fundit në fushën e PP/FT, të vlerësohet në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër PP/FT, të ndikojë dhe të mbështesë aktivitetet dhe përpjekjet e PPP/FT të vendeve anëtare me rëndësi të veçantë për Shqipërinë.

➤ **Grupi Egmont i Njësive të Inteligjencës Financiare:** AIF është anëtare prej vitit 2003 e Grupit Egmont, qëllimi i të cilit është të rrisë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me PP/FT midis vendeve anëtare. Aktualisht i përbërë nga NjIF nga mbi 160 juridiksione, synimet e Grupit Egmont janë nxitja e komunikimit dhe përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, inteligjencës dhe ekspertizës midis rrjetit ndërkombëtar NjIF. Shqipëria luan një rol aktiv në takimet e Grupit Egmont, si dhe shkëmben rregullisht informacione me NJIF partnere.

➤ **Rrjeti rajonal i projektit për mos përhapjen e armëve të dëmtimit në Masë (C-WMD) nën organizimin e DTRA dhe Racviac.** Deri në tetor 2014, ekipi i përbërë nga përfaqësuesit e Komandës Evropiane të SHBA (USEUCOM), Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë si lehtësues, zhvilloi një Objektivat afatmesme Udhërrëfyesin dhe një plan të përgjithshëm për projektin rajonal të Rrjetit të projektit të Mospërhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë. Projekti u lançua zyrtarisht në 2015 me synimin për të mbështetur zhvillimin apo përsosjen e strategjive/planeve kombëtare të reagimit dhe për të rritur bashkëpunimin rajonal në fushën e kundër përhapjes së ADM, midis vendeve të EJK-së, si një projekt i përbashkët midis Komandës Evropiane të SHBA (USEUCOM), Republika e Kroacisë, Agjencia për Reduktimin e Kërcënimeve të Mbrojtjes (DTRA), Programi Ndërkombëtar i Kundër përhapjes (ICP), Iniciativa për Sigurinë e Përhapjes (PSI) dhe RACVIAC – Qendra për Bashkëpunim në Siguri.

Republika e Shqipërisë, bashkë me vendet e Ballkanit Perëndimor, iu bashkuan Rrjetit të MADM, me Republikën e Kroacisë, si një komb mentorues në fazën e parë të projektit.

Takimi i parë i Fazës II të projektit të Rrjetit të MADM, i mbajtur në shkurt 2020, u fokusua në një diskutim gjithëpërfshirës mbi rrugën përpara për Rrjetin e përgjithshëm C-WMD me fokus në katër projekte të reja dhe bashkëpunim më të thellë rajonal.

Është e rëndësishme të vlerësohet se qëllimi i përgjithshëm i Rrjetit të MADM, nuk ishte vetëm krijimi i strategjive kombëtare kundër përhapjes së MADM, por më tepër nxitja e bashkëpunimit rajonal të MADM.

Në fillim të vitit 2020, procesi i zhvillimit të strategjisë ishte i plotë dhe arritjet ishin të konsiderueshme, duke përfshirë zhvillimin e politikave të bazuara në vlerësimin e rrezikut, ndërgjegjësimin për çështjen dhe zhvendosjen dhe rialokimin e burimeve në detyra. Vendet e Rrjetit të projektit të MADM, kanë përmirësuar bashkëpunimin kombëtar ndërinstitucional në këtë fushë dhe në thelb, shkëmbimin e informacionit dhe komandën, kontrollin dhe komunikimin ndër-institucional.

Rrjeti i MADM, ka arritur rezultate të jashtëzakonshme në gjashtë (6) vitet e fundit, duke krijuar kështu një bazë të besueshme për vazhdimin e bashkëpunimit rajonal kundër përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë, në të ardhmen.

Paralelisht me pjesëmarrjen dhe rolin përkatës në organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare dhe rajonale, një dimension tjetër të rëndësishëm për reputacionin dhe pozicionimin në arenën ndërkombëtare përbëjnë edhe vlerësimet nga autoritete/organizma prestigjiozë. Shqipëria përveç vlerësimit nga Moneyval, ashtu si edhe vende të tjera, vlerësohet edhe nga disa institucione apo organizma të tjerë ndërkombëtare ku ndër më kryesoret përmendim:

- **“Basel AML Index - Ranking money laundering and terrorist financing risks around the world”** i publikuar nga Qendra Ndërkombëtare për Rikuperimin e Aseteve (International Centre for Asset Recovery) pranë Institutit të Bazelit për Qeverisje (Basel Institute on Governance). Raporti i fundit është publikuar në 2023¹⁰.

Rezultatet e Institutit të Bazelit mbi Qeverisjen nxirren nga përpunimi i agreguar i 18 indikatorëve që lidhen me kuadrin ligjor dhe rregullativ të PPP/FT, korrupsionin dhe standardet financiare duke përdorur burime publike si FATF që zënë vend parësor, Raporti i DASH për pastrimin e parave, Transparency International, Banka Botërore etj. Që prej vitit 2012 ky Institut realizon publikime të renditjes së vendeve sipas riskut për PPP/FT, renditje e cila nuk synon krahasimin mes vendeve por krijimin e një panorame të përgjithshme mbi nivelin e riskut të secilit vend dhe progresit të tij në kohë.

Objektivi i Institutit është që të ofrojë një renditje sipas riskut të vendeve për PPP/FT, por jo që të masë nivelin e “pastrimin e parave” pasi nuk ka të dhëna të besueshme për të arritur në këtë vlerësim.

Shkalla aktuale e renditjes është nga 0 (risk i ulët) deri në 10 (risk i lartë) dhe ndahet në tre nivele risku: 0 - 3.3 (risk i ulët); 3.3 – 6.6 (risk mesatar) dhe 6.6 – 10 (risk i lartë).

Kështu, në raportin e vitit 2023 janë përfshirë 152 vende dhe në nivel global Shqipëria renditet me pikëzim 4.75, vendi i 93. Nëse krahasojmë renditjen me vitet e kaluara, vendi ynë ka bërë progres të ndjeshëm në pozicionim. Në vitin 2022 Shqipëria renditej me pikëzim 4.92 (në vendin e 74) ndërsa në vitin 2021 renditej me pikëzim 5.72 (në vendin e 39).

- **“International Narcotics Control Strategy Report Volume II Money Laundering”** i publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Raporti i fundit është publikuar në mars 2022¹¹; Në Raportin e DASH për pastrimin e parave, që i referohet të dhënave për vitin 2021, Shqipëria renditet në listën e “Major Money Laundering Jurisdictions”. Në këtë listë me të njëjtin status janë 84 shtete në mbarë botën, ndër të cilat edhe Belgjika, Kanadaja, Kina, Italia, Hollanda, Spanja, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, SHBA etj.

¹⁰ https://index.baselgovernance.org/api/uploads/Basel_AML_Index_2023_12th_Edition_879b07b7b2.pdf

¹¹ <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2022/03/22-00768-INCSR-2022-Vol-2.pdf>

Sipas DASH, statusi si *major money laundering country* përcaktohet nëse institucionet financiare evidentojnë transaksione ku përfshihen shuma domethënëse nga aktiviteti i trafikimit ndërkombëtar të drogës dhe lidhet me Raportin e DASH për narkotikët. Përfshirja në këtë listë, nuk është tregues që shteti nuk po bën përpjekje të forta për të luftuar pastrimin e parave, apo që nuk përmbush standardet ndërkombëtare të fushës. Kjo, nuk është një “listë e zezë” dhe nuk ka sanksione të lidhura me të.

Në përmbledhjen e vlerësimit për Shqipërinë raporti citon: *“Ndërsa Qeveria e Shqipërisë ka bërë përpjekje në parandalimin e PP në vitin 2021, mbetet shumë më tepër për të bërë. Më 1 korrik 2021, një ligj i ri që kërkon nga kompanitë të regjistrojnë edhe pronarët përfitues dhe llogaritë bankare hyri në fuqi. Ligji lejon qasje në kohë reale për autoritetet e zbatimit të ligjit dhe analizën e të dhënave që do të lehtësojë më mirë hetimet e PP dhe krimet financiare dhe gjurmimin e pasurive të paligjshme. Shqipëria miratoi më tej kërkesa të reja që kërkojnë që të gjitha transaksionet të regjistrohen elektronikisht dhe raportohen në autoritetet e taksave në kohë reale. Shqipëria mbetet e ndjeshme ndaj PP për shkak të korrupsionit, pranisë së rrjeteve të krimit të organizuar dhe hendekëve në legjislacion dhe mbikëqyrje. Shqipëria ka një ekonomi të madhe të parave cash dhe sektor informal, me hyrje të konsiderueshme të remitancave dhe investimeve nga jashtë. Trafikimi i substancave narkotike dhe aktiviteti i krimit të organizuar janë burimet kryesore të fondeve të pastruara. Organizatat kriminale shqiptare kanë lidhje me rrjetet që operojnë gjerësisht në të gjithë Evropën dhe në Amerikën e Jugut. Shqipëria vazhdon të përdorë ligjin e saj Anti Mafja për konfiskimin e për të sekuestruar kompanitë e lidhura me trafikimin e drogës dhe korrupsionin. Reforma gjyqësore në proces ka përmirësuar shanset e Shqipërisë për të adresuar PP. Këto përpjekje, megjithatë, ende pengohen nga sfidat e kapacitetit, mbikëqyrja e pamjaftueshme e disa sektorëve dhe nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin mes institucioneve të zbatimit të ligjit dhe atyre mbikëqyrëse.”*

- **Progres Raporti për Shqipërinë 2023**, i publikuar nga Komisioni Evropian. Raporti i fundit është publikuar më nëntor 2023

Raporti nënvizon se Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në **luftën kundër krimit të organizuar**, me një nivel të mirë e të vazhdueshëm bashkëpunimi me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me agjencitë e BE-së. Duhet të bëhen më shumë përpjekje në luftën kundër drogave të paligjshme, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve të autoriteteve të zbatimit të ligjit. Progresi që është arritur me sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të lidhura me krimin e organizuar duhet të vazhdojë. Përpjekjet duhet të vazhdojnë gjithashtu për të siguruar një rritje të numrit të ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare, veçanërisht në rastet e funksionarëve të nivelit të lartë, si dhe për të krijuar zyrën e rikuperimit të pasurisë. Lufta kundër krimit kibernetik, pastrimit të parave, si dhe parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore mbeten fusha ku nevojiten më shumë rezultate.

3.5 Mjedisi aktual dhe trendet e sektorit financiar

Mjedisi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit po evoluon vazhdimisht. Për të siguruar relevancë dhe efektivitet, regjimi PPP/FT duhet të mbajë ritmin me trendet e reja që lindin në sektorët e rëndësishëm, si dhe me zhvillimet ndërkombëtare dhe vendore. Në të njëjtën kohë, regjimi i PPP/FT duhet të monitorohet dhe të adaptohet vazhdimisht ndaj rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që dëmtojnë integritetin e sistemit financiar dhe paraqesin një kërcënim për sigurinë kombëtare.

Teknologjia ka avancuar shpejt në vitet e fundit, me tendenca të rëndësishme drejt digjitalizimit në veçanti në sektorin financiar. Kjo përfshin:

- zhvillime të lidhura me monedhat virtuale, që ofrojnë mënyra të reja për të lëvizur vlera me një gradë të caktuar anonimiteti;
- zhvillimin e teknologjive financiare të reja (Fintech), që po ndryshojnë mënyrat se si njerëzit ndërveprojnë me sistemin financiar; dhe
- njohja e identitetit digjital, që mund të lehtësojë verifikimin e identitetit dhe proceset e detyrimeve të klientëve.

Shumë nga këto teknologji të reja kalojnë kufijtë ndërkombëtarë dhe shpesh nuk kërkojnë një prani fizike për të ofruar shërbime. Koordinimi në nivel global është jetësor për të adresuar rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që shkaktohen nga këto teknologji të reja, si dhe për të përfituar si nga mundësitë që ato ofrojnë për përputhshmërinë me rregullat e PPP/FT ashtu edhe për rritjen ekonomike. Pandemia e COVID-19 ka përshpejtuar këtë trend drejt digjitalizimit, me më shumë konsumatorë financiarë që përdorin kanale digjitale, si dhe me shërbime dhe produkte financiare të reja që bëhen të disponueshme nga teknologjitë në zhvillim. Pandemia gjithashtu ka treguar se aktorët kriminalë po adaptohen në kontekstin aktual duke përdorur skema online dhe mashtrime të lidhura me COVID-19 për të prodhuar fonde. Ky kalim drejt platformave dhe produkteve digjitale mund të prezantojë edhe mundësi të reja për kriminelët dhe organizatat terroriste për të lëvizur fonde. Përvojat e reja nga pandemia COVID-19 përforcojnë rëndësinë e monitorimit dhe kuptimit të rreziqeve të reja në mënyrë të vazhdueshme nga autoritetet kombëtare dhe sektori privat.

3.6 Konteksti i Sigurisë Kombëtare

Parandalimi dhe lufta ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë prioritet të qeverisë shqiptare, pasi këto fenomene paraqesin rrezik për ekonominë kombëtare, sistemin financiar dhe për sigurinë e qytetarëve.

Korniza e sigurisë kombëtare të Shqipërisë ka si prioritet mbrojtjen e sigurisë dhe përmbushjen e nevojave të qytetarëve të saj. Agjencitë dhe organet shtetërore me detyra për të mbrojtur qytetarët dhe interesat e Shqipërisë koordinojnë dhe bashkëpunojnë për të ofruar iniciativa dhe programe në fusha kyçe. Këto përfshijnë adresimin e veprimtarive armiqësore nga aktorë shtetërorë; sigurinë kibernetike, hapësirën dhe teknologjitë në zhvillim; kundërshtimin e

ekstremizmit dhe terrorizmit të dhunshëm; sigurinë kufitare; sigurinë mjedisore dhe shëndetësore dhe lidhjen midis krimit të organizuar dhe sigurisë kombëtare, ndër të tjera. Edhe pse kërcënimet në këto fusha janë të ndryshme, veprimtaria kriminale në secilën fushë zakonisht mundësohet nga pastrimi i parave dhe/ose financimi i terrorizmit. Masat dhe mjetet kundër PP/FT janë gjithashtu të rëndësishme për parandalimin, zbulimin dhe luftën ndaj shmangies së sanksioneve.

Natyra transnacionale e rrjeteve kriminale moderne dhe teknikat që ata përdorin shtojnë kompleksitetin e adresimit të këtyre kërcënimeve, duke nënvizuar nevojën për bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky bashkëpunim operacional mund të zbulojë, shkatërrojë dhe parandalojë më efektivisht pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, dhe të luftojë krimet dhe kërcënimet që ato mundësojnë. Kështu, përpjekjet kundër PP/FT janë të integruara në kornizën më të gjerë të sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike të Shqipërisë.

Në situatën aktuale të sigurisë ndërkombëtare, vendi ynë mbetet një aktor i rëndësishëm dhe i angazhuar në funksion të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit rajonal. Mjedisi i brendshëm i sigurisë i vendit tonë është i qëndrueshëm, pa rreziqe imediate që të çojnë në cenim të integritetit territorial të vendit apo cenim të rendit kushtetues.

Si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat në BE, me kontribute pozitive në vendimmarrjet ndërkombëtare për çështje të sigurisë ndërkombëtare, paqes dhe stabilitetit, Republika e Shqipërisë mbetet një vend me interes për aktorët keqdashës globalë. Ndikimi i tyre pritet të intensifikohet në kuadër të rritjes së konfrontimit dhe qasjes agresive të shteteve kundërshtarë, duke synuar cenimin e arkitekturës aktuale të sigurisë ndërkombëtare dhe asaj evropiane, por edhe të qëndrimit dhe rolit aktiv të Shqipërisë në koordinim me këto organizma.

Në mjedisin strategjik në nivel kombëtar është shumë e rëndësishme evidentimi i rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, të vlerësuara gjerësisht në Vlerësimin Kombëtar të Riskut. Më konkretisht këto aktivitete cenojnë sigurinë ekonomike e cila mund të cenohet edhe nga përpjekjet e aktorëve globalë për të depërtuar në ekonomi për objektiva gjeoekonomike e me synime për ta përdorur ekonominë si mjet presioni politik.

Krimet në ekonomi, gjithashtu, pavarësisht reformave konkrete për uljen e informalitetit, rritjes së forcës goditëse të agjencive ligj zbatuese në luftën kundër këtyre fenomeneve, vijojnë të jenë prezentë e me impakt për ekonominë e vendit dhe rritjen e qëndrueshme të saj, forcimin e institucioneve shtetërore dhe sundimin e ligjit. Mbeten faktor me rrezikshmëri për rritjen e qëndrueshme ekonomike, besueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit financiar, ekonomik në vend. Krimet në ekonomi janë sofistikuar nga teknologjitë e reja financiare dhe përbëjnë shqetësim për shkak të ndikimit në ekonomi. Pastrimi i parave dhe i produktit kriminal është problematikë prezente e me tendenca të larta impakti për ekonominë e vendit dhe sundimin e ligjit.

Korrupsioni dhe perceptimi mbi nivelin e tij minon besimin e publikut tek qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, cenon zhvillimin e vendit, forcimin e institucioneve, rritjen e qëndrueshme ekonomike, si dhe mbetet faktor që ngadalëson dhe dëmton procesin e reformave, si dhe

dekurajon investimet e brendshme e të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë.

Krimi i organizuar ende mbetet fenomen kompleks e dinamik, edhe pse është rritur ndjeshëm forca goditëse, janë forcuar kapacitetet kundërvënëse. Grupet/individët e përfshirë në krimin e organizuar, kryesisht në trafikun, prodhimin e lëndëve narkotike, pavarësisht goditjeve domethënëse të aktivitetit të tyre kriminal, pasurive dhe të ardhurave nga ky aktivitet, kanë treguar aftësi në adaptimin e mënyrave të veprimit në raport me kundërvënien. Të ardhurat e aktiviteteve kriminale të siguruara ndër vite nga shkalla e informalitetit, pandëshkueshmëria apo ndëshkueshmëria e ulët, favorizuar nga korrupsioni në sistemin e drejtësisë, ka sjellë injektimin në ekonominë formale dhe informale të parave të gjeneruara nga aktiviteti kriminal, zhvendosjen e elementëve të spikatur të grupeve kriminale në vendet e Evropës, por edhe të prodhimit e origjinës së lëndëve narkotike. Gjithashtu, përdorimi i teknologjive të informacionit nga rrjetet kriminale, si dhe zhvendosja e aktiviteteve të tyre në hapësirën kibernetike e vështirëson mundësinë e gjurmimit të tyre për t'i vënë para drejtësisë, duke ndikuar për rrjedhojë në rritjen e pandëshkueshmërisë së tyre. Këta elementë të integruar tashmë në rrjete ndërkombëtare të kimit të organizuar vijojnë të nxisin e koordinojnë aktivitetin kriminal të grupeve dhe anëtarëve të tyre brenda vendit.

Terrorizmi dhe radikalizimi drejt ekstremizmit të dhunshëm, financimi i këtyre aktiviteteve, për shkak të influencave të jashtme dhe aktorëve dhe faktorëve të brendshëm e rajonalë do të vijojë të përbëjë rrezik për kohezionin dhe vlerat e shoqërisë shqiptare si dhe për harmoninë dhe bashkëjetesën tradicionale mes besimeve fetare në vend. Edhe pse në vendin tonë nuk ka pasur akte terroriste, ato nuk janë të përjashtuara për shkak të nxitjes e koordinimit nga organizata terroriste, prezencës së LHT-së nga vendi dhe rajoni ende të rreshtuar pranë këtyre organizatave, por edhe mbështetësve të tyre, të cilët të indoktrinuar nga propaganda online mund të veprojnë si aktorë të vetmuar. Influencat e jashtme të linjave ekstremiste fetare vijojnë të influencojnë proceset radikalizuese në vend me synim nxitjen e ekstremizmit në komunitetet e paqta fetare në vend, cenimin e harmonisë dhe bashkëjetesës mes besimeve fetare.

3.7 Pastrimi i parave dhe kërcënimet nga financimi i terrorizmit

Ambienti i kërcënimeve dhe rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri ndryshon ndërkohë metoda të reja për të pastruar paratë dhe financiar terrorizmin po shfaqen dhe po evoluojnë çdo ditë e më shumë. Për të ecur paralelisht me këto zhvillime, AIF dhe disa nga aktorët e sistemit parandalues/ndëshkues, kryejnë vlerësime dhe publikojnë raporte strategjike të inteligjencës për të nxitur vetëdijen e subjekteve raportuese dhe të publikut në lidhje me rreziqet e reja që lindin.

Paralelisht me ndjekjen dhe publikimin e tendencave dhe materialeve edukuese, këto analizohen dhe shërbejnë edhe për evidentimin e mangësive që duhen adresuar. Këto mangësi, të

evidentuara edhe nga vlerësimet ndërkombëtare, por edhe nga Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut, prekin dimensione të ndryshme të sistemit parandalues të PP/FT. Më konkretisht të ndara sipas fushave kryesore ato janë:

Sistemi parandalues:

- Mos dërgim RAD dhe mungesë fokusi në fushën PP/FT nga kategori subjektësh në fushën e kontabilitetit siç janë auditues, kontabilist por edhe agjent të pasurive të paluajtshme;
- Dërgimi i një numri të kufizuar RAD nga kategori të veçanta, siç janë tregtimi i mjeteve motorike, ZKV, Shoqëritë e ndërtimit;
- Rritja e bizneseve të lidhura me veprimtarinë e parasë elektronike, shoqërohet me nevojën për rritje fokusi për trajnime si të vetë subjekteve por edhe mbikëqyrësve.

Mbikëqyrja:

- Staf i kufizuar i ngarkuar me mbikëqyrje për çështjen e PPP/FT në mbikëqyrës kryesor që mbulojnë kategoritë me peshë dominuese të subjekteve raportuese;
- Rritjet e bashkëpunimit për mbikëqyrje të përbashkëta lidhur me subjektet me risk më të lartë.

Hetimi:

- Pavarësisht rritjes së aksesit në databaza të ndryshme, nevojitet shtrirje e mëtejshme e këtij aksesit për personat që kryejnë hetime për pastrim parash, në të gjitha nivelet;
- Nevoja për rritje specializimesh dhe trajnimesh në nivel hetuesish/OPGJ dhe Prokurorët lidhur me tipologjitë e pastrimit të parave, në mënyrë të posaçme për pastrimin e parave si vepër autonome, pastrimin e parave me vlerë ekuivalente, me përfshirje të palëve të tjera të treta, persona juridik, si dhe profesionist, etj.
- Numri i kufizuar i çështjeve të hetuara, dërguara në gjykim, apo me vendim dënimi, për pastrim parash si vepër penale autonome, të kryer nga profesionistë apo nga palë e tretë, që nuk merr pjesë në krimin mëmë;
- Lëvizja e shpeshtë e stafit të specializuar në organet e hetimit.

Informaliteti në ekonomi:

- Pavarësisht masave të marra për uljen e parasë fizike, mbetet ende një instrument gjerësisht i përdorur, i cili në rastet e hetimeve, vështirëson gjurmueshmërinë e lëvizjes së fondeve si dhe përdorimin e tyre.

Kontrolli kufitar:

- Deklarimet në kufi të shumave mbi pragun e raportimit të parashikuar nga ligji PPP/FT vlerësohet të jenë ende në nivel të ulët.

Adresimi i këtyre mangësive së bashku me problematikat dhe çështjet e evidentuara gjatë këtij materiali do të jenë pjesë përbërëse e përcaktimit të objektivave dhe masave përkatëse për arritjen e tyre që do të trajtohen në vijim.

IV. FUSHAT KRYESORE STRATEGJIKE

Dokumenti orientues dhe udhërrëfyes për formulimin e çdo strategjie qeveritare në Shqipëri mbetet SKZHIE 2023-2030¹². Kjo Strategji është dokumenti kryesor strategjik që drejton dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rrugën e integritit të tij në Bashkimin Evropian përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në funksion të arritjes së synimeve të Agjendës 2030 duke përcaktuar vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2024-2030.

SKZHIE paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive të mëposhtme të lidhura me:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej.

Sipas SKZHIE vizioni për zhvillimin kombëtar të vendit është: ***Shqipëria 2030** “Një ekonomi dinamike pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies të të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut.”*

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e PP/FT ndërthuret me SKZHIE në shtyllën e parë të kësaj të fundit: *Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë* e cila parashton nevojën e forcimit të mëtejshëm të institucioneve efikase të vendit si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE. Funksionimi i sistemit të drejtësisë, modernizimi i shërbimeve publike dhe digjitalizimi, arritja e standardeve të BE-së në administratën publike, lufta ndaj korrupsionit dhe

¹² <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88/59519cb2-2180-4e7e-9d91-68545a68e008>

sigurimi i llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik, zgjerimi i decentralizimit dhe demokracisë vendore si dhe përfshirja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në këto procese mbeten përparësi kyçe e qeverisjes të mirë për Shqipërinë.

Objektivat kryesorë të shtyllës së parë të SKZHIE që impaktojnë dhe ndërthuren me Strategjinë janë:

- 1) Reformimi i sistemit të drejtësisë
- 2) Forcimi i proceseve legjislativë dhe zgjedhore
- 3) Politika e jashtme
- 4) Menaxhimi i integruar i kufijve
- 5) Transparenca dhe lufta ndaj korrupsionit
- 6) Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit

Ndërsa pesë masat e para kanë ndikim të tërthortë dhe indirekt me Strategjinë, masa e pestë “Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit” lidhet direkt dhe ka pika të përbashkëta.

Ajo gjithashtu ka si referencë në “Acquis”, Kapitullin 24, “Drejtësia Liria dhe Siguria, Kapitullin 31 “Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes” dhe MSA Titulli VII “Liria, drejtësia dhe siguria” - Nëntitulli: Bashkëpunimi në luftën kundër pastrimit të parave dhe drogave të paligjshme dhe Nëntitulli: Bashkëpunimi kundër terrorizmit.

Një pjesë e objektivave kryesorë si më sipër ndërthuren edhe me gjetjet e vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT, siç janë rritja e efektivitetit në hetimin e veprave kryesore origjinuese të pastrimit të parave që lidhen me krimin e organizuar, korrupsionin.

V. QËLLIMI, OBJEKTIVAT SPECIFIK DHE TREGUESIT E NIVELIT STRATEGJIK

Duke pasur në konsideratë SKZHIE 2024-2030, si dokumenti kryesor strategjik, në vijim synohet të adresohen objektivat strategjik në luftën dhe parandalimin e PP/FT për periudhën 2024 – 2030, të shoqëruara me një plan (masash) veprimi, i cili mbulon periudhën 2024-2027.

Plani i veprimit përbëhet nga qëllimi kryesor dhe objektivat specifik të cilat përcaktojnë masat individuale të përfshira në to. Masat në planin e veprimit janë rezultat i përbashkët i dakordësuar i autoriteteve publike dhe autoriteteve mbikëqyrëse të përfshirë në luftën dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të sektorit privat.

Disa prej masave për reduktimin e risqeve të evidentuara në këtë vlerësim po merren tashmë në nivel kombëtar bazuar në strategji kombëtare të ndryshme si:

- Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025;
- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023 dhe 2022-2025;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimit;

- Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe Plani i Veprimit 2021-2023;
- Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025.

Në këtë strategji trajtohen vetëm masa specifike për arritjen e qëllimit dhe prioritetëve të këtij dokumenti, duke lenë në fuqi masat e përfshira në strategjitë e tjera ndërsektoriale.

5.1 Vizioni dhe misioni i Strategjisë

Strategjia ka si mision të saj të ndikojë në zhvillimin e një sistemi financiar të sigurt dhe me integritet për një ekonomi dinamike që zhvillohet duke përmirësuar dhe modernizuar mekanizmat në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke garantuar sigurinë e shtetasve shqiptarë dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë individuale.

Nëpërmjet objektivave të kësaj strategjie synohet të përforcohen përpjekjet e autoriteteve shqiptare për të penguar elementët kriminalë dhe kërcënimet e lidhura me sigurinë kombëtare të ndërhyjnë në sistemin financiar të vendit dhe për t'i vendosur përpara përgjegjësisë për dëmin që shkaktojnë.

Për të arritur këtë qëllim (vizion) në funksion të përmirësimit dhe modernizimit të regjimit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit Strategjia ka identifikuar 4 prioritetë (misioni):

- 1) Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstucional.
- 2) Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues.
- 3) Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT.
- 4) Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet.

Të gjitha prioritetet ndërveprojnë dhe kanë pika të përbashkëta me njëra tjetrën dhe nuk duhen konsideruar si të shkëputura nga konteksti i përgjithshëm. Në vijim do të trajtohen të detajuar këto prioritetë nëpërmjet 6 (gjashtë) objektivave dhe masave specifike.

Plani i veprimit i paraqitur në Aneksin 1 përshkruan se si do të zbatohen objektivat e përcaktuara dhe ofron informacionin e nevojshëm për veprimet e propozuara, afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në masat e performancës, kërkesat e raportimit dhe monitorimit.

5.2 Objektiv nr.1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstucional

Përmirësimi i politik bërjes dhe koordinimit ndërinstitucional ka si qëllim evidentimin e mangësive ligjore në kuadrin rregullativ dhe ligjor të sistemit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe rritjen dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional duke synuar zvogëlimin e mundësive të shfrytëzimit nga elementët kriminal për të ndërhyrë në sistemin financiar të vendit.

Realizimi i këtij objekti do të përqendrohet në këto veprimtari si vijon:

- Analiza e legjislacionit dhe përputhshmëria e plotë me standardet ndërkombëtare dhe me Direktivat e BE.
- Rritja e efikasitetit të Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës.
- Promovimi i praktikave të partneritetit publik-privat.
- Krijimi i grupeve ndërinstitucionale për sektorët me rrezik të lartë.

Objektivi nr.1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional			
1. Analiza e legjislacionit dhe përputhshmëria e plotë me standardet ndërkombëtare dhe me Direktivat e BE	2. Rritja e efikasitetit të Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës	3. Promovimi i praktikave të partneritetit publik-privat	4. Krijimi i grupeve ndërinstitucionale për sektorët me rrezik të lartë

Masat për arritjen e këtij objekti përfshijnë:

- Kryerjen e vlerësimeve vjetore të përputhshmërisë të kuadrit ligjor të PPP/FT nga GTNP;
- Krijimin e nën grupeve teknike për të analizuar kuadrin rregullator sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve;
- Rritjen e frekuencës së takimeve të GTNP;
- Zgjerimin e numrit të institucioneve dhe subjekteve raportuese që marrin pjesë në takimet e GTNP;
- Programimin e rishikimeve periodike të objektivave strategjike dhe planeve të veprimit;
- Promovimin e praktikave më të mira ndërkombëtare të partneritetit publik-privat. Ndarja e eksperiencës dhe rezultateve të arritura;
- Takime periodike midis përfaqësuesve të institucioneve ligj zbatuese, të inteligjencës, si dhe përfaqësuesve të subjekteve kryesore raportuese;
- Krijimin e grupeve ndërinstitucionale për t'u fokusuar në sektorë me rrezik të lartë, duke kombinuar ekspertizën nga rregullatorët, agjencitë e zbatimit të ligjit, sektori privat dhe agjenci të tjera lidhur me PPP/FT.

5.3 Objektivi nr.2: Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues

Rritja e kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimi publik synon përmirësimin e mëtejshëm të sistemit parandalues në tërësi me qëllim rritjen e aftësisë zbuluese në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Nisur nga fakti që në vlerësimin e fundit nga Komiteti Moneyval efektiviteti rezultoi me mangësi në disa dimensione, nëpërmjet këtij objektivi i është kushtuar rëndësi e veçantë këtyre dy aspekteve duke synuar:

- Kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të nevojave për të identifikuar boshllëqet e kapaciteteve brenda institucioneve kryesore të sistemit parandalues të PPP/FT;
- Përmirësimin e kapaciteteve institucionale duke caktuar burime njerëzore të përshtatshme në numër dhe cilësi në përputhje me nivelin e rrezikut;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve publike, subjekteve raportuese si dhe për publikun e gjerë në lidhje me rrezikun e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë (PP/FT/ASHM);
- Zhvillimin e aktiviteteve publike në funksion të informimit, ndarjes të eksperiencave me sektorin privat dhe edukimin e publikut;
- Komunikimin aktiv në publik i masave të marra dhe arritjeve në fushën e PPP/FT.

Objektivi nr.2: Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues				
1. Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të nevojave për të identifikuar boshllëqet e kapaciteteve brenda institucioneve kryesore	2. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale	3. Rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun e PP/FT/ASHM	4. Zhvillimi i aktiviteteve publike në funksion të informimit, ndarjes së eksperiencave me sektorin privat dhe edukimit të publikut	5. Komunikim aktiv në publik i masave të marra dhe arritjeve në fushën e PPP/FT

Masat për arritjen e këtij objektivi përfshijnë:

- Identifikimin e nevojave për trajnim dhe hartimi i një plani trajnimesh gjithëpërfshirës nga institucionet publike, autoritet mbikëqyrëse dhe përfaqësuesit e sektorit privat;
- Rishikimin e strukturave institucionale duke caktuar burime njerëzore të përshtatshme në numër dhe cilësi në përputhje me rrezikun e subjekteve që mbikëqyrin dhe funksionet që kryejnë;
- Rritjen e angazhimit me subjektet e sektorit privat si bankat, sektori i pasurive të paluajtshme dhe DFNBP-të për çështjet e PP/FT;

- Publikimet dhe shpërndarje tipologjish (PP/FT/ASHM) midis organeve ligj zbatuese, inteligjencës, mbikëqyrësve dhe sektorit privat;
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve institucionale për rrezikun e PP/FT/ASHM me fokus të veçantë sektorët me rrezik të lartë;
- Hartimin dhe shpërndarjen e udhëzimeve të pajtueshmërisë për OJF-të, duke u fokusuar në vigjilencën e duhur, kërkesat e raportimit dhe menaxhimin e rrezikut;
- Promovimin e edukimit financiar në funksion të informimit, ndarjes së eksperiencave me sektorin privat dhe edukimit të publikut;
- Rritjen e kapaciteteve për të mundur komunikim aktiv në publik të masave të marra dhe arritjeve në fushën e PPP/FT.

5.4 Objektivi nr.3: Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT

Ky objektivi kërkon përditësim të rregullt dhe komunikim të kërcënimeve dhe rreziqeve nga financimet e paligjshme, me autoritetet ligj zbatuese dhe vazhdimin e koordinimit ndërinstytucional kundër sfidave prioritare që lidhen me financimet e paligjshme, duke përmirësuar dhe zgjeruar përpjekjet për ndarjen e informacionit dhe përforsim në zbatimin e standardeve ndërkombëtare mbi PP/FT.

Zbatimi i këtij objektivi përfshin:

- Rritjen e aksesit të organeve ligj zbatuese/inteligjencës dhe subjekteve të tjera të përcaktuara në ligj në regjistrat e disponueshëm në vendin tonë;
- Përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit kombëtar në hetimin për veprën penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Rritjen e sekuestrimeve dhe veçanërisht konfiskimeve të aseteve kriminale;
- Zbatimin e një sistemi efektiv të mbledhjes të të dhënave statistikore për PP/FT;
- Rritja e efektivitetit të kontrollit në kufi për deklarimet e parasë fizike apo sendeve me vlerë.

Objektivi nr.3: Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT

1. Rritja e aksesit në regjistrat e disponueshëm	2. Përmirësim i koordinimit dhe bashkëpunimit kombëtar në hetimin për veprën penale të PP/FT	3. Përmirësimi i cilësisë së hetimeve pasurore, e shoqëruar me sekuestime dhe veçanërisht konfiskimeve të aseteve kriminale	4. Zbatimi i një sistemi efektiv të mbledhjes të të dhënave statistikore për PP/FT	5. Rritja e efektivitetit të kontrollit në kufi për deklarimet e parasë fizike apo sendeve me vlerë.
--	--	---	--	--

Masat për arritjen e këtij objektivi përfshijnë:

- Identifikimin e sistemeve/regjistrave të nevojshëm për tu përdorur në parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT;
- Analizimin nga çdo institucion të nevojave për akses në përputhje me funksionet e tyre;
- Sigurimin e aksesit sipas nevojave të institucioneve;
- Vendimarrjen dhe dhënien e aksesit sipas nevojave;
- Vlerësimin e burimeve njerëzore në dispozicion për investigim të PP/FT;
- Takime periodike dhe ndarje tipologjish për PP/FT midis Prokurorive, Inteligjencës dhe Policisë të Shtetit;
- Miratimin i projektligjit dhe nisja e punës të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve;
- Analizimin e sistemeve ekzistuese të statistikave, me qëllim vlerësimin e nevojave për përmirësim;
- Caktimin e pikave të kontaktit nga secili autoritetet kompetent për mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave përkatëse statistikore;
- Përmirësimin e metodës në mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore nga policia e shtetit për rastet e PP/FT;
- Përmirësimin e metodës në mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore nga Prokuroria për rastet e PP, në mënyrë që t'i shërbejnë më mirë analizave, përfshirë analizës së rreziqeve;
- Rivlerësimin e metodologjisë/procedurave/manualëve të lidhura me mënyrën e përcaktimit dhe ushtrimit të kontrolleve në kufi, përsa i përket deklarimit apo mos deklarimit të parasë fizike apo metaleve dhe gurëve të çmuar;
- Përgatitjen dhe shpërndarjen e indikatorëve për evidentimin e rasteve të dyshimta të lidhura me mos deklarimet në kufi dhe shpërndarjen në çdo PKK.

5.5 Objektivi nr.4: Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet

Shqipëria është në një pikë kthese të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore për shkak të një sërë sfidash transformuese të udhëhequra nga tranzicioni digjital. Teknologjitë digjitale po bëhen gjithnjë e më thelbësore në jetën e përditshme. Shqipëria do të shfrytëzojë teknologjinë digjitale për të trajtuar sfidat e mëdha me të cilat do të përballemi në vitet e ardhshme. Synimi strategjik është të jemi një lider digjital në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në harmoni me prirjet digjitale globale duke promovuar agjendën digjitale në mënyrë efektive dhe koherente në të gjitha fushat e politikave të qeverisë dhe ofrimit të shërbimeve, duke punuar ngushtë me të gjithë aktorët pjesëmarrës në zhvillimin e vendit.

Qeveria e Shqipërisë do të ofrojë mbështetje rregullative dhe politike për sigurinë e identitetit digjital dhe për teknologjitë inovative në përputhshmëri me standardet kundër PP/FT dhe do të vazhdojë të përmirësojë përdorimin e inteligjencës artificiale (IA) dhe analizave të të dhënave në përpjekjet për të zbuluar dhe goditur financimet e paligjshme. Sa më sipër evidentuar synohet të arrihet nëpërmjet:

- Ngritjes dhe konsolidimit të sistemeve digjitale të menaxhimit dhe gjurmimit të çështjeve;
- Përdorimi i teknologjisë për rritjen e përputhshmërisë të subjekteve me rregullat kundër PP/FT;
- Përdorimit të IA si instrument ndihmës, në pikasjen dhe analizimin e të dhënave në luftën ndaj PP/FT;
- Vlerësimin dinamik i rrezikut lidhur me PP/FT nëpërmjet përdorimit të mjeteve virtuale dhe teknologjive të reja;
- Përmirësimin i aftësive analitike të agjencive ligj zbatuese përmes mjeteve virtuale si dhe kapaciteteve teknologjike.

Objektivi nr.4: Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet				
1.Ngritja dhe konsolidimi i sistemeve digjitale të menaxhimit dhe gjurmimit të çështjeve	2.Përdorimi i teknologjisë për rritjen e përputhshmërisë të subjekteve me rregullat kundër PP/FT	3.Përdorimi i IA si instrument ndihmës, në pikasjen dhe analizimin e të dhënave në luftën ndaj PP/FT	4. Vlerësimi dinamik i rrezikut lidhur me PP/FT nëpërmjet përdorimit të mjeteve virtuale dhe teknologjive të reja	5. Përmirësimi i aftësive analitike të agjencive ligj zbatuese përmes mjeteve virtuale si dhe kapaciteteve teknologjike.

Masat për arritjen e këtij objektivi përfshijnë:

- Vlerësimin e nevojave për investime në teknologji nga çdo institucion në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe rritjes të efikasitetit dhe rezultateve;
- Plan investimesh në bazë të vlerësimit të nevojave dhe përfshirja në PBA;
- Krijimi i sistemeve të automatizuara për menaxhimin dhe gjurmimin (Case Management) e rasteve në Prokurorinë e Përgjithshme (duke mbuluar të gjitha Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm) si dhe SPAK, duke mundur të kështu përveç nxjerrjes së statistikave edhe gjurmimin e çështjeve dhe rritje e mekanizmave koordinues;
- Koordinimin mes organeve (të mbikëqyrjes, inteligjencës, hetimit) me qëllim rritjen e bashkëpunimit, verifikimeve, kontrolleve në fushën e VASP;
- Analiza sektoriale nga çdo institucion mbikëqyrës, duke analizuar trendet, rreziqet dhe përfitimet bazuar në zhvillimet teknologjike të fushës së mbikëqyrjes;
- Përdorimin e algoritmeve të avancuara dhe të të dhënave për të krijuar modele dinamike të vlerësimit të rrezikut që përshtaten me kërcënimet e reja dhe ato në zhvillim;
- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, shpërndarje tipologjish, të institucioneve publike, autoriteteve mbikëqyrëse dhe sektorit privat lidhur me tipologji të PP/FT përmes mjeteve virtuale si dhe kapaciteteve teknologjike;
- Investim në mjete dhe teknologji analitike për të përmirësuar kapacitetin e agjencive për të analizuar të dhënat financiare dhe për të zbuluar aktivitete të dyshimta;
- Nxitjen e përdorimit të teknologjisë rregullatore (RegTech) që automatizojnë proceset e përputhshmërisë.

5.6 Objektivi nr.5: Rritja e efektivitetit të sistemit mbikëqyrës

Një fokus i veçantë synohet t'i kushtohet sektorit të mbikëqyrjes në mënyrë që të ketë një shpërndarje të orientuar drejt specifikave të sektorëve, duke maksimalizuar kapacitetet e autoriteteve në këtë drejtim si dhe duke synuar zbutjen e rreziqeve për PP/FT/ASHM.

Në këtë aspekt puna do të përqendrohet në këto veprimtari:

- Mbikëqyrje e kategorizuar sipas specifikave të sektorëve;
- Rritja e kapaciteteve dhe trajnimeve;
- Mbikëqyrje e bazuar në risk;
- Shtimi i vigjilencës për subjektet me risk të lartë.

Objektivi nr.5: Rritja e efektivitetit të sistemit mbikëqyrës

1. Forcimi i mbikëqyrjes së sektorëve të identifikuar si me rrezikshmëri të lartë	2. Rritja e kapaciteteve të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse për të adresuar rreziqet e larta që paraqesin sektorë të caktuar.	3. Konsolidimi i mbikëqyrjes të bazuar në rrezik	4. Rritja e numrit të RAD, si dhe larmishmërisë së tipologjive të dërguara nga kategori subjektsh si p.sh kontabilist, auditues ligjor, ndërmjetës në shitblerje pasurish të paluajtshme, shoqëri ndërtimi etj
---	---	--	--

Masat për arritjen e këtij objektivi përfshijnë:

- Krijimin e kornizave të mbikëqyrjes të bazuara në rrezik që prekin sektorët me risk të lartë, duke përqendruar përpjekjet mbikëqyrëse në sektorët më të cenueshëm ndaj PP/FT;
- Zhvillimin e një plani mbikëqyrjeje, duke u fokusuar në sektorët me rrezik të lartë (si bankat dhe pasuritë e paluajtshme, etj) si dhe rritja e shpeshtësisë së inspektimeve;
- Realizimin e programeve të specializuara të trajnimit për rregullatorët, mbikëqyrësit në sektorët me rrezik të lartë për të përmirësuar aftësinë e tyre për të identifikuar dhe trajtuar dobësitë specifike të sektorit;
- Kryerjen e trajnimeve dhe konsultimeve periodike me subjektet me risk të lartë në mënyrë që të rritet cilësia dhe sasia e raporteve të aktivitetit të dyshimtë (RAD);
- Zhvillimin dhe zbatimin e modeleve të avancuara të vlerësimit të riskut për të vlerësuar dhe prioritetizuar kërcënimet e mundshme të PP/TF;
- Përditësimin e manualeve për mbikëqyrjen bazuar në rrezik;
- Vlerësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare për fushën e mbikëqyrjes dhe përfshirjen e tyre në procesin e inspektimeve në vend dhe në distancë.

5.7. Objektivi nr.6: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Në vitet e fundit, Shqipëria ka përparuar ndjeshëm sa i përket përafrimit me standardet ndërkombëtare kundër PP/FT si në aspektin teknik ligjor dhe në drejtim të efektivitetit. Kjo është evidentuar posaçërisht në raportet e fundit 2021-2023 të Komitetit Moneyval, por edhe në progres raportet e Komisionit Evropian.

Këto arritje duhet të avancohen më tej dhe duhet të shfrytëzohen nga institucionet publike shqiptare për të marrë mësimet e duhura dhe për të përmirësuar më tej kuadrin ligjor dhe proceset efektive të punës.

Në këtë kontekst synohet dhe nxiten autoritetet që të përmbushin këtë objektiv nëpërmjet:

- Zgjerimit të bashkëpunimit ndërkufitar;

- Pjesëmarrjen e qëndrueshme në forume ndërkombëtare;
- Angazhimin në vlerësime ndërkombëtare;
- Maksimalizimi i mbështetjes ndërkombëtare dhe ekspertizës.

Objektivi nr.6: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar			
1. Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar për çështjet e PP/FT, veçanërisht me vendet fqinje dhe partnerët kryesorë ndërkombëtarë	2. Pjesëmarrja aktive në forumet dhe iniciativat ndërkombëtare të PP/FT për të mësuar nga praktikatat më të mira dhe për të përafuar përpjekjet me standardet globale	3. Përfshirja e të gjitha institucioneve përgjegjëse në fazat e raportimit gjatë proceseve të vlerësime ndërkombëtare	4. Mbështetja e institucioneve shqiptare me ekspertizën ndërkombëtare për të përmirësuar monitorimin dhe vlerësimin

Masat për arritjen e këtij objektivi përfshijnë:

- Lidhjen ose rishikimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për shkëmbimin e informacionit, hetimet e përbashkëta dhe ndihmën e ndërsjellë juridike për krimet financiare;
- Angazhimin në aktivitetet apo mbledhjet e organizuara nga FATF (Grupin e Posaçëm të Veprimit Financiar), Komitetin MONEYVAL, Grupin Egmont dhe forume të tjera përkatëse për të qëndruar të përditësuar mbi tendencat ndërkombëtare dhe për të përmirësuar bashkëpunimin;
- Pjesëmarrjen në forume ndërkombëtare, procese vlerësimi dhe procese krahasimi për të vlerësuar masat e Shqipërisë për PPP/FT/ASHM kundrejt standardeve dhe praktikave më të mira globale;
- Pjesëmarrje aktive dhe të gjerë në seancat e Moneyval/FATF, Grupit Egmont, grupet e punës dhe takimet rajonale, duke krijuar e zhvilluar një rrjet të qëndrueshëm me këto organizma, si dhe duke synuar promovimin e zyrtarëve nga institucionet shqiptare në organet drejtuese të këtyre organizatave apo në grupet e punës;
- Rolin aktiv të Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare dhe rajonale të fushës së PPP/FT/ASHM;
- Angazhimin maksimal në organizata dhe partneritete ndërkombëtare, për të marrë asistencë teknike, trajnime dhe mbështetje për monitorim dhe vlerësim.

VI. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Organet e ngarkuara parashikohet të raportojnë në AIF çdo 4 muaj për masat e marra në përputhje me planin e veprimit të kësaj strategjie. AIF shërben si sekretariat i Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës, i cili ka në përbërje përfaqësues të gjitha institucioneve anëtare të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave. Raportimi në AIF do të realizohet nga secili institucion përkatës zyrtarisht si dhe përmes anëtarëve të Grupit Teknik Ndërinstitucional i Punës.

Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës parashikohet të mblidhet të paktën 3 herë në vit. AIF realizon përmbledhje të progresit të arritur dhe problematikave, si dhe raporton 2 herë në vit pranë KBLKPP.

Me iniciativën e secilit anëtar të KBLKPP, plani i veprimit mund të ndryshohet periodikisht, në vartësi të dinamikave, nevojave apo rreziqeve të reja që lindin gjatë periudhës së zbatimit.

Ky dokument do shpërndahet në versionin final të gjithë aktorëve kryesorë të përfshirë në këtë proces dhe gjithashtu një version i përmbledhur do të përpunohet me qëllim vendosjen në platformën e AIF për tu aksesuar nga subjektet raportuese.

ANEKS 1: TABELA E PLANIT TË VEPRIMIT 2024-2027

Objektivi nr. 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional											
1.1 Analiza e legjislacionit dhe përputhshmërinë e plotë me standardet ndërkombëtare dhe me Direktivat e BE 1.2 Rritja e efikasitetit të Grupit Teknik Ndërinstitucional i Punës 1.3 Promovimi i praktikave të partneritetit publik-privat 1.4 Krijimi i grupeve ndërinstitucionale për sektorët me rrezik të lartë											
Nr.	Veprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Synimet fillestare	Synimet			Buxheti
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	
1.1.1	Vlerësimi vjetor i përputhshmërisë të kuadrit ligjor PPP/FT	GTNP	GTNP	2024	2027	Dokument vjetor i GTNP me analizën dhe propozimet për ndryshime ligjore					Fondet e institucioneve përgjegjëse
1.1.2	Krijimi i nën grupeve teknike për të analizuar kuadrin rregullator sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve	GTNP	GTNP	2024	2027	Grupe të krijuara sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve Takime të zhvilluara të shoqëruara me informacionet për temat e diskutuara dhe protokollat e takimeve. Iniciativa të propozuara/të ndërmarra për adresimin e risqeve (fokusimi te sektorët që paraqesin risk të lartë).	Grupe të krijuara sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve	Grupe të krijuara sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve	Grupe të krijuara sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve	Grupe të krijuara sipas specifikave dhe rreziqeve të sektorëve	Fondet e institucioneve përgjegjëse

1.1.3	Rritja e frekuencës së takimeve të GTNP	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr i takimeve vjetore të GTNP i shoqëruar me raportin e minutave dhe vendimmarrjen	4	4	4	4	Fondet e institucioneve përgjegjëse
1.1.4	Zgjerimi i numrit të institucioneve dhe subjekteve raportues që marrin pjesë në takimet e GTNP	KBLKPP	GTNP	2024	2027	Vendim nga KBLPP i zgjerimit të pjesëmarrjes në takimet e GTNP	1				
1.1.5	Programimi i rishikimeve periodike të objektivave strategjikë dhe planeve të veprimit	KBLKPP	GTNP	2024	2027	Vlerësime periodike (gjashtë mujore) mbi nevojat e institucioneve për rishikimin e objektivave strategjikë dhe planeve të veprimit dhe rritjen e koordinimit në përputhje me rreziqet në zhvillim.	1	2	2	2	Fondet e institucioneve përgjegjëse
1.1.6	Promovimi i praktikave më të mira ndërkombëtare të partneritetit publik-privat	GTNP	GTNP	2024	2027	Numri i takimeve/aktiviteteve/konferencave të realizuara. Ndarja e eksperiencës dhe rezultateve të arritura	1	2	2	2	Fondet e institucioneve përgjegjëse
1.1.7	Takime periodike midis përfaqësuesve të institucioneve ligj zbatuese dhe të inteligjencës, si dhe të përfaqësuesve të subjekteve kryesore raportuese	AIF, AMF, BSH, MD, DPPSH, PP, SHISH, BMP, AMLF	Autoritet mbikëqyrëse sipas fushës së mbikëqyrjes	2024	2027	Numri i takimeve të shoqëruara me info për temat e diskutimeve	2	3	2	2	Fondet e institucioneve përgjegjëse

1.1.8	Krijimi i grupeve ndërinstitucionale për t'u fokusuar në sektorë me rrezik të lartë, duke kombinuar ekspertizën nga rregullatorët, agjencitë e zbatimit të ligjit, sektorin privat dhe agjenci të tjera lidhur me PPP/FT	KBLKPP	GTNP	2024	2027	Vlerësim periodik për nevojën nga GTNP	Nën grupe të krijuara sipas nevojës fokusuar në sektorët me rrezik të lartë	Nën grupe të krijuara sipas nevojës fokusuar në sektorët me rrezik të lartë	Nën grupe të krijuara sipas nevojës fokusuar në sektorët me rrezik të lartë	Nën grupe të krijuara sipas nevojës fokusuar në sektorët me rrezik të lartë	Fondet e institucioneve të përgjegjëse
-------	--	--------	------	------	------	--	---	---	---	---	--

Objektivi nr. 2. Rritja e mëtejshme e efektivitetit të sistemit parandalues

- 1.1 Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të nevojave për të identifikuar boshllëqet e kapaciteteve brenda institucioneve kryesore
- 1.2 Përmirësimi i kapaciteteve institucionale duke caktuar burime njerëzore të përshtatshme në numër dhe cilësi në përputhje me nivelin e rrezikut
- 1.3 Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve publike, subjekteve raportuese si dhe për publikun e gjerë në lidhje me rrezikun e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë (PP/FT/ASHM)
- 1.4 Zhvillimi i aktiviteteve publike në funksion të informimit, ndarjes së eksperiencave me sektorin privat dhe edukimit të publikut
- 1.5 Komunikim aktiv në publik i masave të marra dhe arritjeve në fushën e PPP/FT

Nr.	Veprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Synimet fillestare	Synimet			Buxheti
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	
2.1.1	Identifikimi i nevojave për trajnim dhe hartimi i një plani trajnimesh gjithëpërfshirës nga institucionet publike, autoritet mbikëqyrëse dhe përfaqësuesit e sektorit privat	GTNP	Të gjithë anëtarët e GTNP	2024	2027	Komunikimi shkresor dhe email me anëtarët e GTNP për identifikimin e nevojave Dokumenti i planit të trajnimeve i konsoliduar me kontributin e të gjithë anëtarëve të GTNP Numri i trajnimeve vjetore të zhvilluara	Plani i trajnimeve (1)	Nr. Trajnimet 3-6 në vit	Nr. Trajnimet 3-6 në vit	Nr. Trajnimet 3-6 në vit	Donator dhe Fondet e institucioneve të përgjegjëse
2.1.2	Rishikim i strukturave institucionale duke caktuar burime njerëzore të përshtatshme në numër dhe cilësi në përputhje me rrezikun e subjekteve që mbikëqyrin dhe funksionet që kryejnë	MD, AMF, BSH, BMP, AMLF, AIF, DPPSH, DPD, DPT	GTNP	2024	2027	Raport mbi ndryshimet strukturore Strukturat e miratuara Buxheti i shpenzuar/alokuar për këtë qëllim	Gjatë vitit	Struktura të rishikuar sipas nevojave të institucioneve	Struktura të rishikuar sipas nevojave të institucioneve	Struktura të rishikuar sipas nevojave të institucioneve	Fondet e institucioneve të përgjegjëse

								e				
2.1.3	Rritja e angazhimit me subjektet e sektorit privat si bankat, sektori i pasurive të paluajtshme dhe DFNBPT-të për çështjet e PP/FT.	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i trajnimeve, forumeve seminareve/ konferencave Vlerësimi i nevojave dhe rezultatet e arritura	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse	
2.1.4	Publikime dhe shpërndarje tipologjish (PP/FT/ASHM) midis organeve ligj zbatuese, inteligjencës, mbikëqyrësve dhe sektorit privat.	GTNP	Ministria e Mbrojtjes, AIF, PP, SPAK, DPPSH, BKH, AMF, BSH, BMP, AMLF, MD, DPD, DPT	2024	2027	Numër publikimesh dhe tematikat përkatëse	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse	
2.1.5	Rritje të ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve institucionale në lidhje me rrezikun e PP/FT/ASHM me fokus të veçantë sektorët me rrezik të lartë	GTNP	GTNP	2024	2027	Numri i trajnimeve/ aktiviteteve/ workshope/ seminare	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse	
2.1.6	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzimeve të pajtueshmërisë për OJF-të, duke u fokusuar në vigjilencën e duhur, kërkesat e raportimit dhe menaxhimin e rrezikut.	DPT DPPSH AIF	DPT	2024	2027	Nr. i udhëzimeve/masave të marra Efekti i këtyre masave Vlerësim nga OJFtë për impaktin.	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse	
2.1.7	Promovimi i edukimit financiar në funksion të informimit, ndarjes së eksperiencave me sektorin privat dhe edukimit të publikut.	GTNP	Të gjitha institucionet e përfshira në GTNP	2024	2027	Nr. i aktiviteteve/takimeve tematike vjetore	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse	
2.1.8	Rritja e kapaciteteve për të mundur komunikim aktiv në publik të masave të marra dhe arritjeve në fushën e PPP/FT	GTNP	AIF, PP, DPPSH, PP, SPAK, DPT, DPD, BMP, BSH, ILDKPKI	2024	2027	Trajnime të zhvilluara Nr. Deklaratat publike/ Konferenca për shtyp në media të shkruara dhe vizive	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse	

Objektivi nr. 3 Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT

3.1	3.1 Rritja e aksesit të organeve ligj zbatuese/inteligjencës dhe subjekteve të tjera të përcaktuara në ligj në regjistrat e disponueshëm në vendin tonë 3.2 Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit kombëtar në hetimin për veprën penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 3.3 Përmirësimi i cilësisë së hetimeve pasurore, e shoqëruar me sekuestre dhe veçanërisht konfiskimeve të aseteve kriminale 3.4 Zbatimi i një sistemi efektiv të mbledhjes së të dhënave statistikore për PP/FT
-----	---

3.5 Rritja e efektivitetit të kontrollit në kufi për deklarimet e parash fizike apo sendeve me vlerë

Nr.	Veprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Synimet fillestare	Synimet				Buxheti
		Institucioni përgjegjës	Institucioni Kontribues				Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027		
3.1.1	Identifikimi i sistemeve/regjistrave të nevojshëm për tu përdorur në parandalimin dhe luftën ndaj PP/FT	GTNP	AIF, DPPSH, PP, SPAK, BKH, AIF, AMF, BSH, BMP, AMLF, MD	2024	2027	Identifikimi i sistemeve/ regjistrave nga institucionet përgjegjës	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.2	Analizë nga çdo institucion i nevojave për akses në përputhje me funksionet e tyre	Të gjitha institucionet e përfshira	GTNP	2024	2027	Analiza e nevojave për akses nga institucionet përgjegjëse	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.3	Vendimarrja dhe dhënia e aksesit sipas nevojave	KBLKPP Organi që administron data bazën AKSHI	GTNP	2024	2027	Numri i kërkesave për akses Numri i sistemeve/ regjistrave për të cilat është dhënë akses	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.4	Vlerësimi i burimeve njerëzore në dispozicion për investigim të PP/FT	Të gjitha institucionet e përfshira	GTNP	2024	2027	Vlerësimi i nevojave sipas institucioneve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.5	Takime periodike dhe ndarje tipologjish për PP/FT midis Prokurorive, Inteligjencës dhe Policisë së Shtetit.	AIF	PP, Prokuroria e Posaçme, DPPSH, SHISH, AIF, DPD, DPT	2024	2027	Nr. i takimeve periodike Nr. i procesverbaleve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.6	Miratimi i projektligjit dhe nisja e punës së Zyrës së Rikuperimit të Aseteve	MB	DPPSH	2024	2027	Ligji i miratuar Ngritja e ARO	Ligji i miratuar	Ngritja e ARO	Funksi onimi i ARO	Funksi onimi i ARO	Funksi onimi i ARO	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.7	Analizimi i sistemeve ekzistuese të statistikave, me qëllim vlerësimin e nevojave për përmirësim	GTNP	AIF, PP, Prokuroria e Posaçme, DPPSH, BKH	2024	2027	Dokumenti i analizës të sistemeve dhe vlerësimin të nevojave	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.8	Caktimi i pikave të kontaktit nga secili autoritet kompetent për mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave përkatëse statistikore.	GTNP	AIF, PP, Prokuroria e Posaçme, DPPSH, BKH	2024	2027	Nr. i pikave të kontaktit Të dhënat statistikore të mbledhura mbi baza tremujore Numri i raportimeve vjetore	Përcaktimi i pikave të kontaktit	Mbledhja e të dhënave statistikore gjatë vitit	Mbledhja e të dhënave statistikore gjatë vitit	Mbledhja e të dhënave statistikore gjatë vitit	Mbledhja e të dhënave statistikore gjatë vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.9	Përmirësimi i metodës në mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore nga policia e	DPPSH		2024	2027	Përmirësimi i mbledhjes të të dhënave statistikore	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe

	shtetit për rastet e PP/FT							vitit	vitit	vitit	Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.10	Përmirësimi i metodës në mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore nga Prokuroria për rastet e PP, në mënyrë që ti shërbejë më mire analizave, përfshirë analizës së risqeve	PP		2024	2027	Përmirësimi i mbledhjes të të dhënave statistikore	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.11	Rivlerësimi i metodologjisë/procedurave/manualeve të lidhura me mënyrën e përcaktimit dhe ushtrimit të kontrolleve në kufi, përsa i përket deklarimit apo mos deklarimit të parasë fizike apo metaleve dhe gurëve të çmuar	DPD		2024	2027	Metodologjia/ procedurat/ manualat e rivlerësuar	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
3.1.12	Përgatitja dhe shpërndarja e indikatorëve për evidentimin e rasteve të dyshimta të lidhura me mos deklarimet në kufi dhe shpërndarjen në çdo PKK	DPD	DPPSH (Kufiri & Emigracionit)	2024	2027	Përgatitja e indikatorëve Nr. i takimeve të realizuara për njohjen e PKK	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
Objekti nr. 4 Përdorimi dhe shfrytëzimi i inovacioneve teknologjike duke zvogëluar rreziqet											
		4.1 Ngritja dhe konsolidimi i sistemeve digjitale të menaxhimit dhe gjurmimit të çështjeve; 4.2 Përdorimi i teknologjisë për rritjen e përputhshmërisë të subjekteve me rregullat kundër PP/FT 4.3 Përdorimi i IA si instrument ndihmës në pikasjen dhe analizimin e të dhënave në luftën ndaj PP/FT 4.4 Vlerësimi dinamik i rrezikut lidhur me PP/FT nga përdorimi i mjeteve virtuale dhe teknologjive të reja 4.5 Përmirësimi i aftësive analitike të agjencitë ligj zbatuese përmes mjeteve virtuale dhe kapaciteteve teknologjike									
Nr.	Veprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Synimet fillestare	Synimet			Buxheti
		Institucioni përgjegjëse	Institucioni kontribuues				Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	
4.1.1	Vlerësimi i nevojave për investime në teknologji nga çdo institucion në funksion të përbushjes së detyrimeve ligjore dhe rritjes së efikasitetit dhe rezultateve	GTNP	Të gjitha institucionet pjesë e GTNP	2024	2027	Raport i GTNP për KBLKPP dhe vendimmarrja për miratim sipas prioritetëve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
4.1.2	Plan investimesh në bazë të vlerësimit të nevojave dhe përfshirja në PBA	GTNP	Të gjitha institucionet pjesë e GTNP	2024	2027	Raport i GTNP për KBLKPP për vitin 2024 dhe vlera e investimeve të alokuara për vitet në vijim	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse

4.1.3	Krijimi i sistemeve të automatizuara për menaxhimin dhe gjurmimin (Case Management) e rasteve në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe SPAK	PP SPAK	GTNP	2024	2025	Sistemi i gatshëm për përdorim	Nisja e punës	Sistemi funksional	-	-	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
4.1.4	Koordinim mes organeve (të mbikëqyrjes, inteligjencës, hetimit) me qëllim rritjen e bashkëpunimit, verifikimeve, kontrolleve në fushën e VASP	AMF AKSHI	AMF, AIF, DPPSH	2024	2026	Analizë dhe plan veprimi për kryerjen e verifikimeve	Dokumenti i analizës i përfunduar	Raport për verifikim met dhe rastet e identifikuar	Raport për verifikim met dhe rastet e identifikuar	-	Fondet e institucioneve përgjegjëse
4.1.5	Analiza sektoriale nga çdo institucion mbikëqyrës, duke analizuar trendet, risqet dhe përfitimet bazuar në zhvillimet teknologjike të fushës së mbikëqyrjes	GTNP	AIF, BSH, AMF, MD, BMP, DPT	2024	2025	Raport përmblendhës nga GTNP për vlerësimet e çdo institucioni	Analiza sektoriale të miratuara	Raporti i paraqitur në KBLK PP			Fondet e institucioneve përgjegjëse
4.1.6	Përdorimi i algoritmeve të avancuara dhe të të dhënave për të krijuar modele dinamike të vlerësimit të rrezikut që përshtaten me kërcënimet e reja dhe ato në zhvillim	GTNP	AIF, BSH, AMF, MD, BMP, DPT	2024	2027	Algoritme Institucionet që i kanë përdorur	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
4.1.7	Rritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, shpërndarje tipologjish, të autoriteteve publike, lidhur me tipologji të PP/FT përmes mjeteve virtuale si dhe kapaciteteve teknologjike.	AMF	AIF, DPSH, PP, SPAK, DPT, DPD, BMP, BSH, ILDKPKI	2024	2027	Trajnime të zhvilluara Persona të trajnuar Tipologji të shpërndara	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
4.1.8	Investimi në mjete dhe teknologji analitike për të përmirësuar kapacitetin e agjencive për të analizuar të dhënat financiare dhe për të zbuluar aktivitete të dyshimta	PP, DPSH, AIF	PP, DPSH, AIF, SPAK, DPT, DPD	2024	2027	Nr. i investimeve Efekti Rezultatet Rritja e kompetencave	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse

4.1.9	Nxitja e përdorimit të teknologjisë rregullatore (RegTech) që automatizojnë proceset e përputhshmërisë	BSH, AMF, BMP, MD, AMLF	BSH, AMF, BMP, MD	2024	2027	Teknologjitë e përdorura Institucionet që i kanë implementuar Rezultatet e arritura	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve të përgjegjëse
-------	--	-------------------------	-------------------	------	------	---	-------------	-------------	-------------	-------------	--

Objektivi Nr. 5: Rritja e efektivitetit të sistemit mbikëqyrës

- 5.1 Forcimi i mbikëqyrjes së sektorëve të identifikuar si me rrezikshmëri të lartë
5.2 Rritja e kapaciteteve të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse për të adresuar rreziqet e larta që paraqesin sektorë të caktuar
5.3 Konsolidimi i mbikëqyrjes të bazuar në rrezik
5.4 Rritja e numrit të RAD, si dhe larmishmërisë së tipologjive të dërguara nga kategori subjektsh si p.sh kontabilist, auditues ligjor, ndërmjetës në shitblerje pasurish të paluajtshme, shoqëri ndërtimi etj

Nr.	Veprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Synimet fillestare	Synimet				Buxheti	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027			
5.1.1	Krijimi i kornizave të mbikëqyrjes të bazuara në rrezik që prekin sektorët me rrezik të lartë, duke përqendruar përpjekjet mbikëqyrëse në sektorët më të cenueshëm ndaj PP/FT	AMF BSH BMP DHASH MD AIF AMLF	AMF BSH BMP DHASH MD AIF AMLF	2024	2025	Nr. i inspektimeve Nr. i shkeljeve të konstatuara Nr. i masave administrative	Hartimi i Dokumentit të kornizave të mbikëqyrjes i miratuar	Dokument i kornizave të mbikëqyrjes i miratuar	-	-			Donator dhe Fondet e institucioneve të përgjegjëse
5.1.2	Zhvillimi i një plani mbikëqyrjeje të bazuar në rrezik, duke u fokusuar në sektorët me rrezik të lartë, si bankat dhe pasuritë e paluajtshme, dhe rritja e shpeshtësisë të inspektimeve	BSH BMP DHASH AMF AIF MD AMLF	BSH BMP DHASH AMF AIF MD AMLF	2024	2027	Nr. i planeve Nr. i inspektimeve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit			Donator dhe Fondet e institucioneve të përgjegjëse
5.1.3	Realizimi i programeve të specializuara të trajnimit për rregullatorët, mbikëqyrësit në sektorët me rrezik të lartë për të përmirësuar aftësinë e tyre për të identifikuar dhe trajtuar dobësitë specifike të sektorit	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i programeve Efekti dhe impakti i tyre Rritja e aftësisë të kompetencës	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit			Donator dhe Fondet e institucioneve të përgjegjëse

5.1.4	Kryerja e trajnimeve dhe konsultimeve periodike me subjektet me risk të lartë në mënyrë që të rritet cilësia dhe sasia e RAD.	Autoritet mbikëqyrëse dhe sektori privat përfaqësues të subjekteve raportuese	GTNP	2024	2027	Nr. i RAD Krahasimore e RAD-ve me periudhat e mëparshme Nr. i trajnimeve/konsultimeve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve ve përgjegjëse
5.1.5	Zhvillimi dhe zbatimi i modeleve të avancuara të vlerësimit të riskut për të vlerësuar dhe priorizuar kërcënimet e mundshme të PP/TF	Autoritet mbikëqyrëse dhe sektori privat përfaqësues të subjekteve raportuese	GTNP	2024	2027	Modelet e përfunduara	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve ve përgjegjëse
5.1.6	Përditësim i manualeve për mbikëqyrjen bazuar në rrezik;	Autoritet mbikëqyrëse dhe sektori privat përfaqësues të subjekteve raportuese	GTNP	2024	2027	Manuale të përditësuara	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve ve përgjegjëse
5.1.7	Vlerësimi i praktikave më të mira ndërkombëtare për fushën e mbikëqyrjes dhe përfshirjen e tyre në procesin e inspektimeve në vend dhe në distancë	Autoritet mbikëqyrëse dhe sektori privat përfaqësues të subjekteve raportuese	GTNP	2024	2027	Nr. i praktikave të përfshira në procesin e inspektimeve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve ve përgjegjëse

Objekti Nr. 6: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

- 6.1 Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar për çështjet e PP/FT, veçanërisht me vendet fqinje dhe partnerët kryesorë ndërkombëtarë
- 6.2 Pjesëmarrja aktive në forumet dhe iniciativat ndërkombëtare të PP/FT për të mësuar nga praktikatat më të mira dhe për të përafëruar përpjekjet me standardet globale
- 6.3 Përfshirja e të gjitha institucioneve përgjegjëse në fazat e raportimit gjatë proceseve të vlerësimeve ndërkombëtare
- 6.4 Mbështetja e institucioneve shqiptare me ekspertizën ndërkombëtare për të përmirësuar monitorimin dhe vlerësimin

Nr.	Veprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Synimet fillestare	Synimet			Buxheti
		Institucioni përgjegjëse	Institucioni kontribues				Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	
6.1.1	Lidhja ose rishikimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për shkëmbimin e informacionit, hetimet e përbashkëta dhe ndihmën e ndërsjellë juridike për krimet financiare.	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i marrëveshjeve të lidhura apo të rishikuara	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve ve përgjegjëse

6.1.2	Angazhimi në aktivitetet apo mbledhjet e organizuara nga FATF (Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar) MONEYVAL, Egmont Group dhe forume të tjera përkatëse për të qëndruar të përditësuar mbi tendencat ndërkombëtare dhe për të përmirësuar bashkëpunimin	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i aktiviteteve/ mbledhjeve/ forumeve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
6.1.3	Pjesëmarrja në forume ndërkombëtare, procese vlerësimi dhe procese krahasimi për të vlerësuar masat e Shqipërisë për të qëndruar të përditësuar mbi tendencat praktikave më të mira globale	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i forumeve ku merret pjesë. Nr. i prezantimeve dhe kontributeve te autoriteteve shqiptare ne këto forume.	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
6.1.4	Pjesëmarrje aktive dhe e gjerë në seancat e Moneyval/FATF, Grupit Egmont, grupet e punës dhe takimet rajonale, duke krijuar e zhvilluar një rrjet të qëndrueshëm me këto organizma, si dhe duke synuar promovimin e zyrtarëve nga institucionet shqiptare në organet drejtuese të këtyre organizatave apo në grupet e punës	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i aktiviteteve/ mbledhjeve/ forumeve Nr. i punonjësve që kanë marrë pjesë	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
6.1.5	Rol aktiv i Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare dhe rajonale të fushës së PP/FT/ASHM	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i aktiviteteve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse
6.1.6	Angazhimi maksimal në organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, për të marrë asistencë teknike, trajnime dhe mbështetje për monitorim dhe vlerësim	GTNP	GTNP	2024	2027	Nr. i aktiviteteve	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	Donator dhe Fondet e institucioneve përgjegjëse